



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2014 ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.
3. Projektligji “Për armët”.
4. Projektligji “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Eduard Halimi dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi, Silva Caka, Arben Ristani, Gent Strazimiri dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Adriatik Ago – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme
Arjan Selita – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme
Dhimitraq Ziu – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme
Renata Palluci – përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Në rendin e ditës kemi tri projektligje që lidhen me Ministrinë e Brendshme: projektligji “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, projektligji “Për armët” dhe projektligji “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Për të tria projektligjet komisioni ynë është për dhënie mendimi.

Dy projektligjet e para janë shqyrtuar dhe janë votuar në parim. Sot kemi votimin nën për nën dhe në tërësi të dy projektligjeve të para, ndërsa projektligji i tretë shqyrtohet sot për herë të parë.

Fillojmë me projektligjin “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

Neni 1.

Relatore është zonja Felaj. Ju lutem, na ndiqni nën për nën!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një sugjerim për nenin 1 të projektligjit: shprehja “legjislacioni në fuqi” të hiqet dhe të zëvendësohet me fjalën “ligji”, pra: “dhe subjekte të tjera të cilave ligji u njeh përdorimin e armëve të zjarrit në përmbushje të detyrave të tyre”, sepse jo i gjithë legjislacioni ka si objekt rregullimin....

Fatmir Xhafaj – Dakord, zonja Felaj.

Ministria është dakord? Dakord.

A ka vërejtje dhe sugjerime të tjera?

Kush është dakord me propozimin e relatores dhe me nenin 1? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. A ka ndonjë gjë për nenin 2?

Ermonela Felaj – Unë jam dakord me pikën 1 të nenit 2 të projektligjit, por sugjeroj që pika 2 e nenit 2 të projektligjit të riformulohet, për arsye se ka një shprehje që më duket e pakuptimtë, pra thuhet: “Ky ligj është i detyrueshëm për punonjësit e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (deri këtu dakord), kur ato përdoren për vendosjen e rendit (kuptohet kujt i referohet përemri “ato”, u referohet forcave që përdorin armë) vetëm në rastet kur forcat e policisë nuk janë në gjendje ta kryejnë atë...”

Fatmir Xhafaj – Bëhet fjalë për Forcat e Armatosura.

Ermonela Felaj – Mirë, pra, por duhet rregulluar fjalia.

Kështu, le ta dëgjojmë variantin e tyre, nëse e kanë parë.

Renata Palluci – Togfjalëshi “kur ato përdoren” jemi dakord që u referohet Forcave të Armatosura.

Fatmir Xhafaj – Është e qartë që u referohet Forcave të Armatosura, por zonja Felaj po ju pyet nëse mund ta saktësojmë, që të jetë shprehja më e qartë.

Armando Subashi – Mund të heqim presjen dhe përemrin “ato”, pra të bëhet “kur përdoren për vendosjen e rendit, vetëm...”.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me këtë ndryshim?

Renata Palluci – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Zonja Felaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po si je dakord? Ke sugjerim? Në qoftë se nuk i kanë rregulluar, thuajua që të mos vinë kot. Është e thjeshtë fare. Cili është propozimi juaj për pikën 2? Unë jam dakord me propozimin e zotit Subashi.

Kush është dakord me vërejtjen e bërë nga zoti Subashi për nenin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizimet”. A ka vërejtje?

Ermonela Felaj – Jemi dakord me nenin 3.

Fatmir Xhafaj – Kolegët?

Vasilika Hysi – “Vendi i izolimit”.

Ermonela Felaj – Më fal, ishim dakord me pikën 3 të nenit 2. Kalojmë te neni 3.

Fatmir Xhafaj – Neni 3 “Përkufizime”.

Ermonela Felaj – Te “Përkufizimet” nuk jemi dakord me përdorimin e shprehjes “vend i izolimit”, sepse është një shprehje me konotacion negativ dhe duhet të zëvendësohet.

Fatmir Xhafaj – A ka një sugjerim?

Zonja Hysi, ju lutem bëni një koment, për ta sqaruar!

Vasilika Hysi – Në fakt, termi “vendi i izolimit” nuk përdoret më. Ne e kemi hequr izolimin edhe si masë nga legjislacioni. Dhomat e paraburgimit dhe vendet e vuajtjes së dënimit janë institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria.

(Diskutime pa mikrofon.)

Përveç rregullimit të përkufizimi i togfjalëshit “vend i izolimit” (është vendi i mbajtjes së personave të cilëve u është hequr ose u është kufizuar liria, se do ta shohim si e ka Kushtetuta dhe konventa), ai do të rregullohet edhe në çdo paragraf të ligjit.

Fatmir Xhafaj – Ministria dakord?

Adriatik Ago – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Vetëm ka një gjë, ju është thënë që herën e kaluar ta bëni këtë gjë.

Adriatik Ago – Nuk i kemi pasur këto sugjerime.

Fatmir Xhafaj – Bledi, ju nuk jeni këshilltar këtu për të na ndjekur ne, por për të mbajtur shënime dhe për të bërë korrigjime. Në qoftë se kjo nuk është korrigjuar, është vërejtje për ju si këshilltar.

Dakord me vërejtjen e bërë. Kush është dakord me nenin 3, që do të reflektohet pastaj në të gjithë projektligjin? Dakord.

Miratohet me vërejtjen e bërë.

Neni 4 “Kushtet e përdorimit të armës”.

Ermonela Felaj – Them që në formulimin e nenit 4 të merrnim parasysh formulimin e nenit 2 që përmban ligji aktual “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, sepse besoj se aty është marrë fjalë përmbajtja e neneve që lidhen me “nevojën ekstreme” dhe me “mbrojtjen e nevojshme”. Nuk lejohet që një ligj më i ulët t’i referohet një ligji më të lartë, siç është Kodi Penal. Konkretisht, të themi që të gjitha këto subjekte, të cilave ligji u njeh të drejtën e përdorimit të armëve, kanë të drejtë të përdorin armët e zjarrit për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tyre ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit që kërcënon atë, një person tjetër apo pasuritë e tyre nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbrapsur. Ky është sugjerimi im për këtë nen, sepse këto janë dy rastet kur lejohet përdorimi i armëve të zjarrit.

Vasilika Hysi – Lidhur me pikën 1 të nenit 4, i referohem nenit 2 të Konventës dhe raportit shpjegues të saj, që policia mund ta përdorë armën e zjarrit vetëm kur është absolutisht e domosdoshme, pra jo “e domosdoshme”, por “absolutisht e domosdoshme”.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni.

Armando Subashi – Edhe unë jam dakord me propozimet e kolegeve. Nuk e di nëse mund të gjendet një fjalë tjetër në vend të fjalës “absolutisht”, gjithsesi duhet theksuar, sepse kjo është ideja që ta theksojmë sa më fort këtë.

Te pika 2 jam dakord që ne duhet ta detajojmë dispozitën, sepse po e lamë, imagjinoni atë policin fundor që do t’i bjerë rasti të përdorë armën, i cili duhet të dijë se ç’janë nenet 19, 20 të Kodit Penal.

Fatmir Xhafaj – Zoti Ago, besoj jeni dakord, sepse është thjesht detajim për të qenë më i qartë.

Adriatik Ago – Dakord jemi.

Fatmir Xhafaj – Që të mos e pyesni atë, por ne, do t’i marrim dy dispozitat e Kodit Penal do t’i vendosim në ligj, në mënyrë që të jetë më e kuptueshme gjatë leximit dhe përdorimit të ligjit. Mos të bëjmë referencë neni që polici të hapë nenin.

Zoti Majko.

Pandeli Majko – Mos duhet hequr fjala “mund”, se keni të sqaruar të gjithë nenin. Neni 4 e ka titullin “Kushtet e përdorimit të armës” dhe jo “Kushtet e mundësisë së përdorimit të armës”.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me sugjerimin për nenin 4?

Adriatik Ago – Për sa i përket fjalës “mund”, ne mendojmë të qëndrojmë, sepse e drejta është një mundësi që u njeh ligji punonjësve të policisë për të kryer ndaj të tjerëve kryerjen ose moskryerjen e veprimeve të caktuara. Pra, në këtë kuptim ajo duhet të qëndrojë si mundësi, për arsye se janë edhe një sërë masash të tjera deri sa të shkojë tek arma.

Pandeli Majko – Ndërrojeni titullin atëherë dhe bëjeni “Kushtet e mundësisë së përdorimit”.

Adriatik Ago – Ne kemi konceptin në kuptimin subjektiv të së drejtës si një mundësi që u njihet punonjësve të policisë dhe jo si detyrim.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me nenin 4 me sugjerimin që u bë për paragrafët? Në rregull.

Neni 5 “Evidentimi i armëve të zjarrit në regjistër”.

Ermonela Felaj – Jemi dakord me nenin 5.

Fatmir Xhafaj – A ka vërejtje ose sugjerime nga kolegët?

Armando Subashi – Kam vetëm një pyetje që e kam mbajtur shënim. A mund ta zëvendësojmë fjalën “evidentimi” me fjalën “regjistrimi”, sepse evidentimi është një proces pak më i lehtë dhe më sipërfaqësor se sa regjistrimi?

Adriatik Ago – Në përmbajtje jemi njësoj, por, duke pasur parasysh proceset që bën policia për rastet e regjistrimit, evidentimi është një nga proceset, pra është përditësimi në regjistër.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Dakord me nenin 5.

Neni 6 “Përgjegjësia për pasojat e përdorimit të armës”. A ka ndonjë gjë?

Ermonela Felaj – Në nenin 6 të projektit do të ishte më e saktë sikur të thoshim: “Punonjësit e policisë apo subjektet e tjera, të cilat përdorin armë zjarri, kanë përgjegjësi, përveç rasteve në të cilat punonjësi...”. Pra, shmangim dy fjalë që më duken parazitare “gjithmonë” dhe “personale”, sepse ne për përgjegjësinë personale **mendojmë**, përgjegjësinë kolektive nuk e njohim.

Vasilika Hysi – Lidhur me ligjshmërinë ose me kundërligjshmërinë, mos është më mirë të themi “...kur i dhënë nga drejtuesi i operacionit për të qëlluar është i ligjshëm...”.

Armando Subashi – Mund ta themi edhe kështu siç thotë Vasilika.

Adriatik Ago – Për sa i përket përgjegjësisë, ne duhet ta theksojmë që përgjegjësia është gjithmonë personale.

Fatmir Xhafaj – Atë po thotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adriatik Ago - Të lihet personale.

Fatmir Xhafaj – Po, pra.

A jeni dakord me sugjerimet e bërë për nenin 6? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “E drejta për përdorimin e armës së zjarrit”.

Ermonela Felaj – Në fakt, e kemi sugjeruar edhe gjatë diskutimit në parim të këtij projektligji që në përmbajtjen e nenit 7 të këtij projekti të reflektohet jo vetëm e drejta e jetës dhe shëndetit, por edhe interesa të tjera, siç është pasuria, sepse edhe Kodi Penal e mbrohet pasurinë dhe e njeh mbrojtjen në të dyja rastet, në mbrojtjen e nevojshme dhe në nevojën ekstreme. Kështu, ne nuk mund ta shmangnim nga fokusi edhe pasurinë. Në fakt, ju e keni thënë te germa ‘ç’ e nenit 7, por vetëm indirekt, ku thuhet: “për të zmbrapsur sulmin ndaj një objekti publik apo privat...”. Duhet ta përfshijmë te pika 1 e nenit 7.

Fatmir Xhafaj – Përfaqësuesit e ministrisë?

Adriatik Ago – Mendoj se germa “ç” e nenit 7 e zgjidh këtë problem, kur bëhet fjalë për mbrojtjen e një objekti publik ose privat. Po të konceptohet ligji në tërësi, janë edhe nene të tjera që e mundësojnë mbrojtjen e pronës.

Ermonela Felaj – Mund të sulmosh edhe subjektin për t'i dëmtuar interesat e tij, jo vetëm objektin, se ka një ndryshim në këtë rast. Prandaj, sugjeroj që në nenin 7, pika 1, germa 'a', aty ku thuhet "për të mbrojtur jetën, shëndetin", të shtohet edhe "të drejtat dhe interesat e tyre ose të të tretëve".

Armando Subashi – A mund t'ju bëj një pyetje: pra, aty ku thuhet "për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e tij" bëhet fjalë kur është në kryerje të detyrës, kur mund të jetë jashtë shërbimi, apo në të dyja rastet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në të dyja rastet, në rregull.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord me sugjerimin e bërë te neni 7, për të cilin ramë dakord me Ministrinë e Brendshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

"Vendi i izolimit" do të rregullohet te përkufizimet dhe do të transmetohet aty ku do të jetë ky term. Dakord me nenin 7, me vërejtjen e relatores me të cilën ra dakord edhe Ministria e Brendshme.

Neni 8 "Shmangia e rrezikut publik".

Ermonela Felaj – Në fakt, kemi pasur dy diskutime lidhur me nenin 8 të projektit. Njëri diskutim bëhet duke e krahasuar me ligjin aktual. Në ligjin aktual parashikohet që të mos quhet si një mënyrë ose si një mundësi që forcat e policisë duhet ta përdorin, kur është e mundur, ndaj të miturve, grave dhe të moshuarve. Në këtë ligj nuk e gjejmë. E diskutojmë si do ta lëmë, se edhe unë kam diskutime për këtë pikë. Ndërkohë, them që në përmbajtje të këtij neni të shtohet: "synimi i forcave të policisë ose edhe i forcave të tjera që janë të lejuara të përdorin armë zjarri, kur t'i përdorin ato, të jetë të qëllojnë jo në pjesët vitale të trupit, por në pjesët e poshtme". Ky është një përcaktim që e ka ligji aktual dhe mua më duket i mirë që të mbahet. Megjithatë, ju dëgjojmë edhe ju dhe vendosim.

Fatmir Xhafaj – Ministria?

Adriatik Ago – Për sa i përket të qëlluarit në pjesët e tjera të trupit, praktikisht është e pamundur dhe nuk mund të realizohet.

Fatmir Xhafaj – Po ligji që e kishte deri tani?

Adriatik Ago – Në qoftë se e ka pasur ligji, janë disa kritere të tilla shumë subjektive të cilat nuk realizohen praktikisht, por, duke e vënë si një detyrim ligjor, sikur e vëmë përpara përgjegjësisë një punonjës policie. E rëndësishme është të vërtetohet që ekziston e drejta e përdorimit të armës, pra e drejta për të qëlluar...

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, nuk jemi tek ajo pikë, por jemi te shmangia e rrezikut publik. Ajo që po thonë është mundësia e parë që duhet dhënë, që ti të evitosh...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Derisa ligji ekzistues e ka pasur më mirë, nuk kemi asnjë arsye pse të mos e bëjmë siç është. Kështu, këshilltarët të shikojnë ligjin ekzistues së bashku me relatoren.

Ermonela Felaj – Ideja është për të adoptuar paragrafin e dytë të nenit 7 të ligjit aktual, ku thuhet: “kur personi nuk i bindet urdhrit, por përpiqet të largohet ose të reagojë, qëllohet pa paralajmërim, duke synuar pjesët e poshtme të trupit”. Pra, nuk është detyruese dispozita, por është orientuese.

Fatmir Xhafaj – Besoj se është e qartë edhe për kolegët e tjerë. A ka ndonjë gjë të veçantë, që të mos merremi me detaje?

Vasilika Hysi – Në pikën 3 sugjeroj të ndryshohet fjala “turmë”. Janë grumbullime të njerëzve, por jo turma. Ka shumë konotacion negativ. Njerëzit mund të dalin dhe të protestojnë për të drejtat e tyre, por nuk janë turma.

Fatmir Xhafaj – Cila shprehje do të ishte më e duhura? “Mbi demonstruesit?”

Vasilika Hysi – “Grumbullime”.

Fatmir Xhafaj – A biem dakord? Dakord.

Neni 8 miratohet me sugjerimet e bëra te pikat 2 dhe 3.

Neni 9 “Paralajmërimi për përdorimin e armëve të zjarrit”.

A ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 “Përdorimi i armëve të zjarrit ndaj kafshëve”. A ka pyetje?

Pandeli Majko – Te pikat 1 dhe 2 mos e keni fjalën për kafshë urbane? Kam përshtypjen se e keni tepruar pak, sidomos te pika 3, që polici duhet të raportojë për çdo kafshë të vrarë. Kafshë quhet edhe miu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rregullojeni pak. Për shembull, te pika 3 të thoni “kafshë të mbrojtura”, te pikat 1 dhe 2, ku flisni për kafshë qytetase, të thoni kafshë urbane ose për përdorim shtëpiak.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk ka sens që polici të raportojë me shkrim për një kafshë.

Adriatik Ago – Është parë në këndvështrimin e rrezikshmërisë që paraqet kafsha në rrethana të caktuara. Për shembull, për një fëmijë të mitur, edhe miu mund të bëhet rrezik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht, sepse mund të mbartë një sëmundje së cilës nuk i dihet trendi...

Fatmir Xhafaj – Nuk ka rëndësi, se ligji nuk merret me seleksionimin e kafshëve. Ju lutem, të mos e kthejmë në...

Kush është dakord me nenin 10?

Ikni po të doni dhe vrisni një pëllumb në rrugë në Gjermani dhe do të shikoni që duhet të shkoni në polici.

Renata Palluci – Janë konventa të tëra në mbrojtje të të drejtave të kafshëve.

Fatmir Xhafaj – Në polici dhe të bëjnë edhe raport. Kush është dakord? Kundër? Në rregull.

Neni 11 “Komisioni i shqyrtimit të rasteve të përdorimit të armës”.

Ermonela Felaj – Ne jemi dakord me pikën 1 të nenit 11. Ndërkohë që se si do të funksionojë ky komision dhe se cila do të ishte përbërja e tij, do të ishte e mira ta sillnim në këtë ligj dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave. Duhet të përcaktohet këtu në ligj se çfarë do të bëjë ky komision dhe sa fuqi do të ketë vendimi i tij. Nuk e di nëse keni ardhur sot me ndonjë projekt për përmbajtjen e këtij neni.

Fatmir Xhafaj – A mund të na e shpjegoni se çfarë është ky komisioni për shqyrtimin e rasteve të përdorimit të armës?

Adriatik Ago – Ky komision ka si qëllim të përcaktojë nëse përdorimi i armëve të zjarrit është bërë në përputhje me procedurat standarde të operimit të Policisë së Shtetit. Ka qëllim t’i ofrojë rekomandime drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të përmirësuar trajnimet, problemet e menaxhimit apo për hartimin e politikave dhe procedurave standarde që rregullojnë përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit. Pra, **nuk shkon deri aty sa** futet në valle prokuroria, se armët mund të përdoren edhe kur nuk kanë pasoja. E gjithë kjo procedurë duhet analizuar. Ky është qëllimi i komisioneve.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Subashi.

Armando Subashi – Gjithsesi, shpjegimi që dha besoj se nuk e ezauron të gjithë shqetësimin që kemi në këtë pikë, sepse jam dakord që ky mund të jetë një nga kushtet dhe ndoshta duhet theksuar këtu, pra në rastet kur nga përdorimi i armëve të zjarrit nuk kanë ardhur pasoja. Kur themi pasoja, bëhet fjalë për jetën ose për shëndetin, pra nuk kemi plagosje, vrasje etj. Mund të mos ketë pasojë të tillë, por Kodi Penal e njeh, gjithsesi, si vepër penale edhe rastin kur nuk kemi një pasojë. Dua t’ju sjell në vëmendje këtu edhe Institutin e Tentativës. Tentativa nuk kërkon patjetër që personi të ketë një dëmtim të shëndetit të vet, sepse mund të qëllohet kundrejt një personi dhe mund të mos i shkaktohet asnjë dëmtim, por përsëri jemi në kushtet e tentativës. Kështu, mendoj se ndoshta do të duhet ta specifikojmë shumë më qartë këtë dispozitë, pra deri ku shkon ky komision dhe a mund të jetë kusht që nuk kemi një çështje penale të filluar nga prokuroria, sepse, në fund të fundit, po ta themi pak më shqip, çfarë do të bëjë ky komision?! Do të mblidhen 5 burra, 7 burra ose 9 burra dhe gra do të thonë “Po, në rregull, arma është përdorur në zbatim me

ligjin apo nuk është përdorur në kushtet e ligjit”. Pra, çfarë lloj atributi është ky që ky komision mund të marrë, në raport me zbatimin ose jo të ligjit, sepse ky nuk është një ligj që mund të ketë pasoja administrative. Përdorimi i armëve të zjarrit ka efekte shumë të rëndësishme për jetën dhe për shëndetin e njerëzve. Pa dyshim që çdo veprim që kryhet, ose mosveprim në këtë rast, ka implikime penale. Mendojeni si do ta formulojmë këtë dispozitë dhe deri ku do të shkojmë me këtë komision, në raport me prokurorinë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Lutaj.

Piro Lutaj – E gjej me vend shqetësimin për arsye të rëndësishme që ka mënyra e përdorimit dhe përbërja e komisionit, por, meqenëse lidhur me armët ne kemi disa institucione dhe njëri institucion nuk i përdor ose nuk ka të drejtë t’i përdorë armët si një institucion tjetër, unë mendoj të përfshijmë në pikën 2 të kësaj dispozite titullarë të institucioneve përkatëse. Për të qenë me konkretë, përdorimi i armëve të zjarrit në Forcat e Armatosura ka kritere ndryshe nga ç’i ka përdorimi i armëve, po themi, nga forcat e Gardës së Republikës. Në këto kushte, ne duhet të përfshijmë këtu titullarët e institucioneve, si Ministrinë e Brendshme, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin Informativ, për aq sa lejohet përdorimi i armës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen me udhëzim të titullarit të institucionit shtetëror, të cilit i njihet e drejta e përdorimit të armëve.

Armando Subashi – Ne duam të dimë se ç’është ky komision dhe deri ku do të shkojë, pastaj si përbëhet.

Fatmir Xhafaj – Zoti Frroku.

Mark Frroku – Lidhur me analizimin e rasteve kur përdoret arma, pra si përdoret dhe ku përdoret, ne kemi një problem shumë të madh, sepse mjetet e Policisë së Shtetit nuk kanë asnjë lloj pajisje të montuar, pra nuk kanë as kamera dhe as pajisje audio. Kjo do të thotë se lihet shkak që polici të abuzojë në përdorimin e armës. Besoj se kjo pikë është e avancuar për kushtet që kemi ne. Duhet ta shikojmë këtë ligj edhe me ligjin e vjetër. Për shembull, ajo që tha kolegja para, pra që të qëllohet në brez e poshtë për neutralizimin, mua më duket shumë e drejtë dhe e saktë, sepse lihet shumë vend për abuzim ndaj qytetarit nga punonjësi i policisë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti kryetar, nuk kam mbaruar ende. E kam fjalën që këto mjete të pajisen me këtë logjistikë.

Fatmir Xhafaj – Për sa i përket pjesës së parë të vërejtjes që bëtë ju zoti Frroku, u përfshi ajo, kurse kjo është një çështje...

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Lidhur me komisionin e shqyrtimit të rasteve të përdorimit të armës, kërkoj që ky komision të jetë i pavarur. Është detyrim standard i pavarësisë së institucionit. Duhet të parashikojmë parimet e funksionimit, përbërjen e këtij institucioni në ligj. Ky është detyrim europian, pra nuk lejohet ta bësh me akte nënligjore. Gjithashtu, duhet parashikuar nëse do të jetë kompetent për hetimin e rasteve që përbëjnë shkelje administrative dhe jo penale, sepse në këtë mënyrë dublohet organi që merret me hetimin.

U lutem kolegëve të Ministrisë së Brendshme që të shohin edhe rastet si do të përdoret arma e zjarrit, sepse është shumë e rëndësishme të parashikohet në ligj që të përdoret nga njerëz të kualifikuar, të ketë një plan të veprimit, i cili duhet të jetë jo me gojë, por me shkrim (janë rregulla dhe standarde evropiane) dhe duhet të përcaktohet dokumentacioni. Pra, rregullat e përdorimit të armës së zjarrit janë detyrues në ligj dhe jo në akte nënligjore. Në asnjë vend nuk është me akte nënligjore. Ajo që ju mungon juve në ligj është përcaktimi i rregullave të përdorimit të armës së zjarrit, përcaktimi i ndalimeve eksplicite, siç e kërkon neni 2 i Konventës së Përdorimit të Armëve të Zjarrit dhe çfarë do të bëhet nëse arma e zjarrit është përdorur? Pra, cilat janë veprimet e komisionit?

Fatmir Xhafaj – Zonja Felaj, keni fjalën.

Ermonela Felaj – Në vijim të idesë së zonjës Hysi, duke iu rikthyer nenit 7 të projektit, aty ka një pikë 2, ku thuhet se Këshilli i Ministrave miraton rregullat e detajuara për përdorimin e armëve të zjarrit. Unë mendoj se është pavend që këtë prerogativë t’ia japim Këshillit të Ministrave, sepse nuk ka asnjë lloj ekspertize në fushë që të përcaktojë këtë gjë. Do të ishte mirë që komisioni, për mendimin tim, mund të veprojë përpara ndodhjes së rastit dhe mund ta bënte këtë punë. Ai nuk mund të veprojë më pas, sepse unë nuk e di çfarë vlere ka realisht. Për prokurorinë dhe për gjykatën nuk ka asnjë lloj vlere, sepse rastet e nevojës ekstreme dhe mbrojtjes së nevojshme i çmojnë vetë ata, nuk marrin mendim nga askush. Për këtë punë nuk ka mendim ekspertit, e çmon prokuroria dhe gjykata, sepse jua ka dhënë këtë të drejtë kodi.

Fatmir Xhafaj – Po në rastin kur polici ka gjuajtur në ajër, nuk shkon fare në prokurori?

Ermonela Felaj – Nuk i marrim mendim ekspertit.

Fatmir Xhafaj – Ata duan ta vlerësojnë nëse ka qenë në kushtet e nevojshme.

Ermonela Felaj – Kur nuk është plagosur, kur nuk është vrarë njeri, ose kur nuk është shkatërruar asgjë. Këto janë rastet, ndërsa të tjerat le t'i përcaktojnë këta.

Fatmir Xhafaj – Rastet e tjera duhet t'i heqim ne që të mos i dalim ndesh prokurorisë.

Ermonela Felaj – Sugjerimi im është që ky komision le të përcaktojë rastet e hollësishme të përdorimit të armëve të zjarrit, jo Këshilli i Ministrave, sepse nuk ka ekspertizë për këtë gjë. Domethënë, nuk kemi pse t'ia lemë Këshillit të Ministrave dhe ta bëjmë me vendim, sepse nuk ka kuptim.

Së dyti, le të ndahen rastet, meqë e keni merak, çfarë është përgjegjësi e ndryshme nga ajo penale.

Fatmir Xhafaj – Nuk e kam merak personal, duhet ta kuptoni, nesër mund të ndodhemi përpara kushtit që është konsumuar një vepër penale dhe ngrihet një komision në ministri, i cili vihet përballë qëndrimit që mban organi i prokurorisë, ku thotë se përdorimi i armëve është korrekt, në përputhje me ligjin. Unë sugjeroj që ta riformuloni bashkë me ekspertët.

A jeni dakord?

Vasilika Hysi – Përveç riformulimit të nenit, i cili duhet të përcaktojë përbërjen e komisionit dhe të gjitha parimet mbi të cilat funksionon, në ligj është e domosdoshme të parashikohet sesi veprohet në rast se punonjësi i policisë ka përdorur armën e zjarrit. Bëhet fjalë për të dhënë ndihmën e shpejtë, për të raportuar tek eprori, për të njoftuar, sepse, nëse e ka plagosur, ai nuk mund ta lërë aty. Janë disa parime dhe standarde, të cilat duhet të sanksionohen në ligj.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka nevojë për komente nga ministra, ajo që duhet është e qartë, kolegët nuk janë dakord me këtë formulim dhe do të ribëhet.

Neni 12.

Ermonela Felaj – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Aktet nënligjore”.

Ermonela Felaj – Unë mendoj ta heqim detyrimin e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte nënligjore në rast të nenit 7 të projektit, pika 2.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Shfuqizimet”.

Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Hyrja në fuqi”.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ermonela Felaj – Ne kemi sugjeruar edhe herën tjetër, por duhet ta mbajmë parasysh në miratimin përfundimtar të projektit, që të këmbëjnë vendet e neneve 8 me 7. Pra, më përpara të vihen rastet kur nuk lejohet të përdoret arma e zjarrit, më pas kur lejohet, sepse bën sens edhe me qëllimin që ka ky ligj: që të lejojë përdorimin e armëve të zjarrit, por duke siguruar garantimin e të drejtës së jetës dhe të shëndetit. Prandaj duhet vënë se kur nuk përdoret dhe më pas kur përdoret, sepse është shumë të rëndësishme.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord me sugjerimin e zonjës Felaj.

Këtu mbyllet diskutimi dhe debati për këtë projektligj.

Ekspertët e ministrisë dhe këshilltari nën kujdesin e relatores, para se të firmosë raportin, të bëjnë sot reflektimet e nevojshme, siç e lamë këtu, përfshirë edhe ndryshimin e nenit 11.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2014 ora 09:32

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për armët”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Eduard Halimi dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi, Silva Caka, Arben Ristani, Gent Strazimiri dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Adriatik Ago – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Arjan Selita – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Dhimitraq Ziu – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Renata Palluci – përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme

Fatmir Xhafaj - Kalojmë te projektligji “Për armët”.

Neni 1.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizime”.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Llojet e armëve”.

Ermonela Felaj – Pse janë hequr nga përkufizimi i ligjit aktual armët që kategorizohen që nga A7 deri tek A17? A keni një shpjegim për këtë?

Adriatik Ago – Në pamje të parë të krijohet përshtypja sikur janë hequr, por në ligjin e vjetër është bërë tërësisht listimi i direktivës së vitit 1991, ndërsa sasia që është këtu është sepse direktiva e vitit 1991 ka pësuar amendim në vitin 2008. Kështu që vetë direktiva e vitit 2008 ka përcaktuar deri te shkronja “g” kategorinë A5. Meqenëse këto bëjnë pjesë tek armët e grupit A, do të thotë se janë vdekjeprurëse, pjesa tjetër, që e ka hequr vetë direktiva, nuk është e tillë. Kështu që është reflektim direktive.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “Kategorizimi i armëve”.

Kush ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Moscenimi i legjislacionit për armët ushtarake”.

Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “E drejta e pronësisë mbi armët”?

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “Regjimi juridik për kategoritë e armëve”.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Regjimi për hyrjet dhe daljet e armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10 “Regjistrimi i armës së zjarrit”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Qitja eksperimentale”.

Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Kuptimi i veprimtarive të lejuara me armët”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Licencimi”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Llojet e licencave”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Licenca për import-eksport dhe tregtim për armët e kategorive të ndryshme, “B1”, “B4”, “C” dhe “D””.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16 “Licenca për transportin e armëve”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 16? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Licenca për poligon civil qitjeje”.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Licenca për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armët”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 18. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 “Kriteret e përgjithshme të licencimit”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 “Dëshmia për aftësimin teorik dhe praktik për armën” .

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Drejtuesit teknikë”.

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 “Detyrimet e subjektit të licencuar”.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23 “Inspektimi”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 “Llojet e autorizimeve”.

Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25 “Autorizimi për blerje arme zjarri për personat juridikë”.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 “Autorizimi për blerje arme për personat fizikë”.

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27 “Autorizimi për mbajtjen e armës së zjarrit në shërbim dhe në lëvizje”.

Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 28 “Autorizimi për mbajtje arme zjarri në vendbanim”.
Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 28? Kundër? Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 29 “Autorizimi për mbajtjen e armëve të ftohta”.
Kush është dakord me nenin 29? Kundër? Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 30 “Autorizim i posaçëm për mbajtje arme”.

Zoti Paloka ka pyetje për këtë nen.

Edi Paloka – Me sa di, kjo ka qenë e përcaktuar në ligjin e mëparshëm dhe e detajuar, pse tani i kalon si kompetencë Këshillit të Ministrave?

Fatmir Xhafaj – Në pikën 2 thuhet: “Procedura për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Zoti Ago, cili është komenti juaj?

Adriatik Ago – Aktualisht në Policinë e Shtetit ka një procedurë, ku ky aktivitet rregullohet me VKM, por për shkak të frymës së re që ka ligji, ne duam ta pasqyrojmë këtë frymë dhe komisioni që është në Policinë e Shtetit vlerëson kërcënimin e rrezikut ndaj personave që do të shfaqen si të tillë. Kështu që nuk ka asnjë ndryshim nga ligji i vjetër.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera, sugjerime, vërejtje, komente ose propozime?
Nuk ka.

Miratohet neni 30, me sqarimin e bërë.

Neni 31 “Autorizimi për mbajtje arme gjahu, sportive dhe armë të tjera”.

Ka pyetje, vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 31? Kundër? Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 32 “Autorizimet për përdorim skenik dhe për koleksionim armësh”.

Ka pyetje, vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 32? Kundër? Abstenim? Nuk ka.
Miratohet.

Neni 33 “Autorizimi për rimbushjen e municioneve”.

Zonja Hysi, ka pyetje.

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje në lidhje me pikën 3 të këtij neni, ku thuhet: “Personi fizik i pajisur me autorizim për këtë proces ka të drejtë të blejë dhe të mbajë deri

në pesë kilogramë barut për rimbushjen e municionit të armëve të gjahut”. Ku e keni bazuar këtë sasi? A mund të mbajë dikush pesë kilogramë barut, kur ne kemi vënë kritere shumë strikte në Kodin Penal për mbajtjen e municioneve? A jeni në gjendje të kontrolloni përdorimin e tyre thjesht për efekt të armëve të gjahut apo që mund të përdoren për arsye të tjera?

Fatmir Xhafaj – Zoti Ago, urdhëroni!

Adriatik Ago – Sasia prej pesë kilogramësh në kushtet tona është më normale. Në referencën që i kemi bërë draftit me ligjet e vendeve të BE-së, italianit i ka minimumi 10 kilogramë. Ne e kemi vënë pesë dhe është tërësisht e kontrollueshme dhe nuk përbën burim rreziku për këtë lloj aktiviteti.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 33? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34 “Kriteret për t’u pajisur me autorizim”.

Ermonela Felaj – Kemi dy sugjerime në lidhje me nenin 34 të projektit. Pse është vënë mosha 22 vjeç? Po t’i referohemi Kodit të Familjes, dy janë kufijtë moshorë që përdoren, 18 dhe 25. Mosha 25 vjeç mua më duket më e përshtatshme sesa 22, sepse në moshën 22 vjeç njerëzit janë ende në marrëdhënie studimi apo shkolle.

Vërejtja tjetër lidhet me pikën 4 të nenit 34. Pse duhet të pajisen personat me disa autorizime, me tre apo pesë, për të mbajtur armë? Ju i keni dhënë të drejtë çdo personi të pajiset me jo më shumë se tri autorizime të armëve të të njëjtit lloj, ose jo më shumë se pesë autorizime të armëve të llojeve të ndryshme. Pra, pse njerëzit duhet të mbajnë tre apo pesë armë?

Adriatik Ago – Në lidhje me moshën, kjo moshë u vendos në harmoni me draftet e tjera dhe me mendimin e institucioneve të Ministrisë së Drejtësisë, që mosha 22-vjeçare është më e përshtatshme, më e pjekur në raport...

Fatmir Xhafaj – Pse jo 23 vjeç?

Dakord, psikologët shqiptarë thonë se 23 vjeç je i pjekur!

Adriatik Ago – Është edhe në harmonizim me ligjin e SHRSF-së.

Fatmir Xhafaj – Po kjo me tri autorizime dhe pesë autorizime?

Adriatik Ago – Kjo është një e drejtë, e cila është edhe në direktivë. Ne e kemi ulur numrin për kushtet e vendit tonë, sepse vendet e tjera e kanë më shumë.

Fatmir Xhafaj – Ma shpjegoni si mund t’i jepni një njeriu autorizimin të mbajë tri armë dhe pse?

Adriatik Ago – Sepse e drejta e pronësisë e kërkon një gjë të tillë, që një njeri ka të drejtë të mbajë një çifte, dy çifte, një teke.

Fatmir Xhafaj – Kur bëhet fjalë për armë gjahu?

Adriatik Ago – Po, bëhet fjalë për armët e gjahut dhe armët e koleksionit, që ne nuk ia presim dot të drejtën të ushtrisë profesionistëve të tij.

Fatmir Xhafaj – Këtu nuk është ky kuptim. Po të jetë për koleksionistët, ai mund të mbajë 20, por edhe 50 armë.

Adriatik Ago – Jo, sepse edhe koleksionisti do t'i nënshtrohet këtij kufizimi.

Fatmir Xhafaj – Që të ketë tri armë ose pesë armë vetëm?

Adriatik Ago – Të mbajë tri armë të të njëjtit lloj dhe jo më shumë se pesë autorizime të armëve të llojeve të ndryshme. Domethënë, me llogaritë që bëjmë ne, ai mund të mbajë maksimumi 15 armë.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Adriatik Ago – Kjo shifër është në harmonizim me direktivën për koleksionistët. Është marrë mendimi i Shoqatës dhe i Federatës së Koleksionistëve të Shqipërisë dhe është pasqyruar.

Fatmir Xhafaj – Po për një njeri që ka pistoletë dhe mban tri pistoleta të ndryshme?

Adriatik Ago – Jo, në asnjë mënyrë.

Fatmir Xhafaj – Deri në tre thoni ju.

(Diskutime pa mikrofon.)

Adriatik Ago – Për ne nuk përbën rrezik sasia e armëve me këtë lloj kufizimi për personat që plotësojnë kriteret e këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Ne e kemi problem mbajtjen e armëve. Ju keni ardhur këtu dhe keni kërkuar ashpërsim të Kodit Penal për armëmbajtjet pa leje.

Adriatik Ago – Pikërisht bëhet fjalë për armëmbajtjet pa leje. Ndërsa burimi i rrezikut për armët me leje në praktikën e deritanishme...

Fatmir Xhafaj – E kuptoj kur je koleksionist për armët e gjahut, por për armët e tjera të zjarrit pse? Sipas mendimit tim, koleksionisti mund të mbajë edhe 50 armë, jo vetëm 15. Ai po të dojë le të mbajë 100 armë, mjafton që ato të mos jenë të rrezikshme. Por që të mbajë tri pistoleta të llojeve të ndryshme?

Adriatik Ago – Atëherë, le ta lemë vetëm për armët e gjahut për të mbajtur këtë lloj kufizimi.

Fatmir Xhafaj – Koleksioni dhe armët e gjahut.

Zoti Frroku, keni fjalën.

Mark Frroku – Unë mendoj se për koleksionistët të mos ketë kufizim, sepse nuk mundemi që për koleksion t'u lëmë vetëm tri armë. Ai mund të ketë edhe 30, por edhe 300, mjafton që ato të mos jenë funksionale. Pra 3 mund të jenë funksionale. Koleksioni për atë bëhet. Ai e ka pasion dhe le të ketë armë sa të dojë, por të mos jenë funksionale.

Ndërsa për armët e gjahut është normale që të jenë dy, tri, edhe katër, sepse edhe ai e ka për sport dhe i duhen tri lloj armësh të ndryshme: mund të ketë një teke, një çiftë dhe një *shotgun* që zë shtatë fishekë.

Xhemal Qefalia – Te “germa “ë” e nenit 34 thuhet: “Të gëzojë besueshmëri”. Besueshmëri përballë kujt? Ju i keni vënë kriteret këtu: të jetë i aftë, të ketë aftësi fizike dhe mendore, të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike. Ky është një subjektivitet. Do shefi i policisë ose organi kompetent ta licencojë ose nuk do.

Adriatik Ago – Besueshmëria në këtë ligj, por edhe në paketat e tjera për herë të parë gëzon një koncept të ri. Besueshmëria është proces verifikimi i të dhënave të individit në raport me të gjitha *database*-t.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është në përkufizim se çfarë do të thotë besueshmëri. Në këtë koncept është proces verifikimi dhe lihet gjurmë për problemet e besueshmërisë dhe nuk është në dorën e një individi që, qoftë shef komisariati, qoftë drejtor, të mund të mbajë qëndrime subjektive që ta japë ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sipas llojit: është shefi i komisariatit për rrethin, është drejtor i qarkut për autorizimin dhe është drejtor i përgjithshëm për licencimet.

Fatmir Xhafaj – Zoti Majko, keni fjalën.

Pandeli Majko – Unë kam biseduar me zotin Ago, bëhet fjalë për nenin 34, i cili ka lidhje me nenin 40. Te germa “a” unë propozoj që të hiqet fjala “të jetë shtetas shqiptar” Ku qëndron problemi? Sepse te neni 40 thuhet: “Mbajtja e armës nga autoritet e huaja”. Ne kemi barazuar diplomatët e huaj që kemi në Shqipëri dhe të drejtën e tyre për mbajtje arme, ata janë të gjithë njerëz me një status special, me germën “d” të nenit 40: “Shtetasit e huaj që vijnë në Republikën e Shqipërisë për veprimtari sportive të qitjes dhe gjuetisë”.

Shtetasit e huaj që vijnë për gjueti në Shqipëri kanë bërë një masakër të paparë. T'u japësh këtyre të njëjtin status me punonjësit diplomatë të misionëve diplomatike në Shqipëri është e paimagjinueshme.

Fatmir Xhafaj – Ata nuk e marrin armën te ne.

Pandeli Majko – Nëse një gjuetar i huaj do të vijë të bëjë sport në Shqipëri, të vijë të regjistrohet dhe të plotësojë kushtet e terrenit shqiptar. Ai nuk mund të ketë të njëjtin status me diplomatin e misionit diplomatik në Shqipëri.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk ka lidhje me nenin 34, por kur të shkojmë te neni 40.

(Zoti Majko ndërhyr pa mikrofon.)

Këtu është për shtetasit shqiptarë që shkojnë të blejnë armë. Ai nuk shkon të blejë armë, ai e ka, sepse ia ka dhënë shteti italian.

(Zoti Majko ndërhyr pa mikrofon.)

Ai nuk merr autorizim për t'u pajisur, ai e ka armën.

Adriatik Ago – Shtetasi i huaj vjen me armë dhe i nënshtrohet regjimit të brendshëm. Ai e ka marrë armën nga shteti i tij dhe nuk i nënshtrohet regjimit tonë për t'u pajisur me autorizim. Neni 34 “të jetë shtetas shqiptar” bën fjalë për shtetasit tanë që kërkojnë të pajisen me një nga llojet e autorizimeve që jep ligji. Për shkak të të drejtës së pronësisë, shtetasi i huaj vjen me armën që ka marrë në shtetin e tij dhe këtu do t'i nënshtrohet vetëm regjimit të administrimit dhe të përdorimit të armëve brenda territorit të shtetit shqiptar.

(Zoti Majko ndërhyr pa mikrofon.)

Është tërësisht e rregulluar, që shtetasit e huaj, edhe kur vijnë për aktivitet sportiv apo për gjueti, i nënshtrohen edhe ligjit për gjuetinë, edhe akteve të këtij ligji dhe akteve nënligjore që do të dalin nga ky ligj. Ne jemi shumë të sigurt që e mbyllim ciklin për të mos lejuar asnjë vakuum ligjor në drejtim të respektimit. Për të huajt bëhet kërkesa nëpërmjet Ministrisë së Jashtme.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi ka një koment.

Vasilika Hysi – Unë e mbështes kolegen Felaj për të rritur moshën nga 22 në 25 vjeç. Te germa “c” thoni: “Të mos ketë qenë i dënues me parë me veprim të formës së prerë për veprën penale të kryer me dashje”. Ne kemi raste të veprave penale të vrasjes nga pakujdesia me armë zjarri, të plagosjes së rëndë. Për rrjedhojë unë jam për çdo rast ku vepra penale është kryer me përdorim të armës së zjarrit, sepse edhe një person që kryen vrasje nga pakujdesia tregon që nuk di ta përdorë armën e zjarrit, është i pakujdesshëm dhe i pavëmendshëm.

Te germa “ç” thuhet: “Të mos ketë qenë i evidentuar për rastet e rezistencës me dhunë”. Unë kërkoj që kjo të riformulohet, por edhe fjala “evidentim” duhet rregulluar, duhet shqipëruar, dhe të themi: “Për të mos qenë i evidentuar për rastet e kundërshtimit me dhunë”, siç e ka edhe ligji, edhe Kodi Penal, përdor fjalën “kundërshtim” dhe jo “rezistencë”.

Ermonela Felaj – Në fakt, jam dakord me këto që tha zonja Hysi, sepse do të ishte mirë që të ishte kështu : “Të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale të kryera me armë zjarri”. Me armë zjarri kryhet edhe vrasja nga pakujdesia, edhe plagosja e rëndë nga pakujdesia.

Kur një njeri është i pakujdesshëm, nuk gëzon besueshmëri në përgjithësi.

Fatmir Xhafaj – Zoti Ago, keni fjalën.

Adriatik Ago – Në lidhje me moshën, nëse ju bini dakord, ne mund ta rrisim.

Fatmir Xhafaj – Po, po, jemi dakord.

Adriatik Ago – Për sa i përket zëvendësimit të fjalës “rezistencë” me “kundërshtim”, jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 34 me sugjerimet dhe vërejtjet e bëra? Dakord.

Miratohet.

Neni 35 “Raporti mjekësor”.

Ermonela Felaj – Raporti mjekësor të mos jetë më i vjetër se tre muaj në momentin kur paraqitet. Pra, raporti mjekësor të mos jetë i para një viti ose i para dy vjetve. Domethënë, në momentin kur paraqitet personi për t’u pajisur me autorizim, raporti i tij mjekësor të mos datojë në një kohë më shumë sesa tri muaj.

Vasilika Hysi – Unë kam diçka për pikat 3 dhe 5.

Në pikën 3 ju thoni, në kuptimin e këtij ligji, “çdo strukturë shëndetësore”. Unë sugjeroj që nuk mund ta lejojmë një mjek të një qendre shëndetësore në komunë të certifikojë, por duhet të themi: “Në qendrat shëndetësore të specializuara për kontrollin e shëndetit mendor”.

Fatmir Xhafaj – Ai është mjek dhe, nëse konstaton se një person që mban armë ka çrregullime, shumë mirë e ka.

Vasilika Hysi – “Llojet e vizitave dhe përmbajtja e raportit mjekësor përcaktohet me udhëzim të ministrit të...”. Të cilit ministër?

Fatmir Xhafaj – Të ministrit të Brendshëm.

Adriatik Ago – Me ministrin nënkuptojmë ministrin përgjegjës.

Fatmir Xhafaj – Kush është dakord me nenin 35, me sugjerimet e zonjave Felaj dhe Hysi për pikën 5? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36.

Ka pyetje, vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 36? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37.

Ka pyetje, vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 37? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 38 “Akti i vetëm administrativ”.

Kush është dakord me nenin 32? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 39.

Vasilika Hysi – Ju thoni se veprimet për tjetërsimin ose transferimin e të drejtave të tjera mbi armët në pronësi të etj., nuk ushtrohen mbi bazën e një licence.

A mund të ma sqaroni se çfarë keni dashur të thoni me paragrafin e parë të nenit që flet për tjetërsimin në kushtet e përdorimit vetjak?

Së dyti, çfarë ndodh nëse personi e humbet të drejtën e përdorimit ose një të drejtë tjetër mbi armët? Në këtë rast thoni se njoftohet organi përgjegjës. Çfarë ndodh konkretisht?

Adriatik Ago – Duke iu referuar përmbajtjes dhe frymës së ligjit, ne kemi regjistruar të gjitha veprimtaritë e lejuara me armë. Në rastin konkret, në nenin 39, bëhet fjalë për një shitje me pakicë midis a-së dhe b-së. Kur a-ja kërkon t’i shesë b-së armën që e ka në pronësi, b-ja, përpara se ta marrë, duhet të ketë marrë autorizimin për blerje arme. Në kuptimin e përgjithshëm kjo quhet veprimtari e lejuar me armë, që në ligjin e vjetër kjo është veprimtari me licencë. Në këtë veprimtari, për shkak se është si shitje me pakicë, e kemi bërë me autorizim, edhe kur vjen me origjinë importi dhe eksporti. Pra, nuk bëhet për përdorim vetjak, që a-ja të shkojë jashtë shtetit dhe të blejë një çiftë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht për përdorim vetjak nuk kemi dashur ta ndërlikojmë këtë problem që a-ja të shkojë te kompania dhe shumë hesape të tjera. Ai pajiset te ne, duke plotësuar kriteret e këtij ligji me autorizimin për të blerë, shkon e blen dhe u nënshtrohet të gjitha rregullave të shtetit shqiptar për detyrimin doganor, sistemin e taksave e shumë gjëra të tjera dhe bëhet pronar i ligjshëm i pronës së tij. Ky është qëllimi i këtij neni.

Vasilika Hysi – Mënyra si e shpjegoni nuk përputhet me përmbajtjen e nenit 39. Ju pranoni tjetërsim për përdorim vetjak, ndërkohë, që personi që ka nevojë për të marrë një armë për përdorim vetjak, shkon dhe licencohet për ta marrë. Ju thoni: licencim dhe transferim. Transferim është edhe dhënia me qira, apo ta japësh në përdorim për një kohë të caktuar dhe ai të ta kthejë. Kjo është të kesh biznes për shitje apo dhënie me qira të

armëve, në kushtet e përdorimit vetjak. Mua më duket, se nëneni 39 bie ndesh me atë që kemi thënë më parë në lidhje me përcaktimin se kush ka të drejtë të pajiset me armë dhe si pajiset me armë.

Adriatik Ago – Edhe një herë, të nderuar deputetë,

Subjekti licencohet për veprimtaritë e lejuara me armë. Individit i jepet autorizim për të drejtat që ai ka, në përputhje me këtë ligj, për t’u bërë pronari i një arme. Në rastin konkret të nenit 39, bëhet fjalë për veprime individuale midis individëve dhe jo midis subjekteve që janë të licencuar. Këtë logjikë ka.

Ermonela Felaj – Po shikoj përmbajtjen e ligjit aktual dhe është nëneni 10 i ligjit aktual: “Autorizimi për tjetërsim, në kushtet e përdorimit vetjak”.

Ka pak ndryshim me përmbajtjen që keni sjellë ju sot, sepse këtu thuhet: “Veprimet për tjetërsimin ose transferimin e të drejtave të tjera mbi armët e gjahut dhe ato sportive”. Pra, i përcakton konkretisht, se për cilat armë bëhet fjalë. Jo të gjitha armët, se ju këtu keni thënë: “Veprimet për tjetërsimin ose transferimin e të drejtave të tjera mbi armët e në pronësi private”.

Adriatik Ago - Në raport me nënenin 10 të ligjit ekzistues, kemi konceptin e ri, ku bëhet fjalë për armët në pronësi private. Ligji ekzistues nuk e ka këtë lloj filozofie. Gjithmonë, bëhet fjalë për mbi armët e gjahut dhe ato sportive. Pra, e kemi futur konceptin për armët në pronësi, sepse ligji...

Fatmir Xhafaj –Dakord! Sugjerimi është që ta përcaktoni, sepse ky është shqetësim i drejtë i komisionit. Po e the për të gjitha armët, pa kufizim, përbën problem. Po e the për armët e gjahut dhe armët sportive, kjo është tjetër gjë, ka tjetër logjikë, është më e zbutur. Jeni dakord?

Adriatik Ago – Dakord!

Flitet gjithmonë kur personi A e ka lejen e armës. Në këtë prizëm flasim. Mua më duket shumë i saktë propozimi juaj. Kur personi A ka lejen e armës, personi B, merr autorizimin dhe ia kalon armën.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Jeni dakord me sugjerimin në nënenin 39?

Miratohet.

Kalojmë në nënenin 40. Zoti Majko keni ndonjë koment?

Pandeli Majko – E përsëris edhe një herë, këtu thuhet: “për shtetasit e huaj që vijnë në Shqipëri për gjueti sportive, që kanë të njëjtin status me ushtarakët e NATO-s, Policisë Ndërkombëtare dhe të Misionit Diplomatik”. Kjo është turp! Të paktën, të thuhet mbi bazën e marrëveshjeve reciproke. Keni dëgjuar për ndonjë shqiptar që shkon në Itali për gjueti?

Fatmir Xhafaj – Po, shkon në Maqedoni.

Pandeli Majko – I lini këto! Vjen këtu qytetari i huaj dhe ka statusin e ushtarit të NATO-s, apo të misionit diplomatik! Ç’është kjo?! Të paktën të thuhet mbi bazën e marrëveshjeve reciproke. Kanë ardhur dhe kanë bërë masakra. Unë kam disa lidhje me shoqatën.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, të vihet: bazuar mbi ligjin “Për Gjuetinë”.

Pandeli Majko – Jo, të thuhet: mbi bazën e marrëveshjeve reciproke.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Atëherë, mund ta specifikoni. Jeni dakord me këtë sugjerim?

Janë dakord përfaqësuesit e ministrisë?

Adriatik Ago – Jemi dakord me sugjerimin tuaj!

Kush është dakord me nenin 40 me sugjerimin e zotit Majko?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 41.

Kush është dakord me nenin 41?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 42, “Pushimi i së drejtës për mbajtje arme”.

Kush është dakord me nenin 42?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 43, “Trajtimi i armëve provë materiale”.

Kush është dakord me nenin 43?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 44, “Disponimet për armët”.

Kush është dakord?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 45, “Armët e koleksionit”.

Kush është dakord?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me amendamentin Lame?

Miratohet.

Neni 46, “Mbledhja e të dhënave personale”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 47, “Evidentimi i të dhënave për armët”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 48, “Tarifat financiare”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 49, “Llojet e masave shtrënguese”.

“Në kuptim të këtij ligji, për shkeljet e konstatuara, jepen këto masa shtrënguese:

a) pezullim i licencës dhe i autorizimit;

b) revokim i licencës dhe i autorizimit”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Më pas, neni 50 shpjegon pezullimin e licencës.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 51, “Revokimi i licencës”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 52, “Pezullimi i autorizimit”.

Ka vërejtje dhe propozime?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 53, “Revokimi i autorizimit për mbajtje arme”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 54, “Ankimi administrativ”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 55, “Ankimi në gjykatë”.

Ka vërejtje dhe propozime?

S'ka. Po keni kaluar këtë filtër, jeni në rregull, sepse komisioni ynë i shikon më me kujdes këto gjëra.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 56, "Kundërvajtjet administrative".

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mos u shqetësoni për gjrobat e larta! Sa më të larta t'i kenë, aq më mirë është.

Neni 57, "Dispozitë kalimtare".

Kush është dakord?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 58, "Nxjerrja e akteve nënligjore", me sugjerimet që u bënë për t'i reflektuar më lart këshilltarët, të cilët i kanë mbajtur shënim.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 59, "Shfuqizime".

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 60, "Hyrja në fuqi".

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ermonela Felaj – Këtu ka disa parashikime për të nxjerrë akte të ndryshme nënligjore. Me ç'shikoj, këtu janë shumë akte nënligjore. Ju i keni dhënë të drejtë vetes, që këto akte nënligjore të përgatiten për 6 muaj, ndërkohë, që ligji hyn në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Pra, ligji hyn në fuqi, para se të përgatiten aktet nënligjore.

Mospasja në kohë e akteve nënligjore a e cenon zbatueshmërinë e ligjit? Kemi parasysh që ligji aktual po shfuqizohet, pra, jemi pa ligj. Ligji i ri nuk i ka gati aktet nënligjore. Mospasja e në kohë e akteve nënligjore a e cenon zbatueshmërinë e ligjit, apo jo?

Adriatik Ago – Ne i kemi paraprirë kësaj pakete me akte nënligjore dhe po punojmë paralelisht me shumë nëngrupe të tjera, duke respektuar afatin që jep ligji.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, keni ndonjë propozim, zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Meqë ju e keni përgatitur si paketë dhe unë ju falënderoj për këtë nismë, sugjeroj që të jetë afati 3 muaj nga hyrja në fuqi e akteve dhe s’kemi pse të lëmë afatin 6 muaj dhe të krijojmë një vakuum 6-mujor.

Fatmir Xhafaj – Edhe ne, kolegët e tjerë, e mbështesim këtë propozim.

Vasilika Hysi – Më falni, zoti kryetar, por dua t’i kthehem nenit 46. Kemi ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë ligj rregullohet si mbledhja, përpunimi dhe asgjësimi i të dhënave që mblidhen në veprimtarinë tuaj.

Në pikën 3, të nenit 46, thuhet: “Gjatë veprimtarisë së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave zbatohen dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Po për arkivimin dhe asgjësimin e tyre, kur nuk ju duhen më, do të vazhdoni t’i mbani? Prandaj do të kërkoj nga ju dhe nga këshilltarët e komisionit ta plotësoni pikën 3, sipas kërkesave dhe direktivave evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pra, policia të kërkon të dhëna dhe i mban përjetësisht, ndërkohë që ka rregulla për mbledhjen, përpunimin, asgjësimin dhe për përdorimin e tyre.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Do t’ia kërkojmë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Jeni dakord? Zoti Ago, keni fjalën!

Adriatik Ago – Ky nen është bërë *mot a mot*, sipas propozimit që ka bërë Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky është propozimi i tyre, i bërë në këtë formë.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Zoti Ago, së bashku me zonjën Hysi që e njeh mirë këtë fushë, do t’iu lutesha që mbas mbledhjes...

Ermonela Felaj – Është një detaj shumë i vogël, që është mirë ta themi: te përkufizimet nuk i keni përkufizuar “armët me tojë”, ndërsa, në përmbajtjen e ligjit e gjen si shprehje.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Vendoseni te përkufizimet!

Zoti Subashi keni fjalën për të bërë pyetjen, para se ta votojmë në tërësi projektligjin.

Armando Subashi – Pyetja ime ka të bëjë me të gjitha procedimet penale që ndodhin sot në prokurori dhe gjykata lidhur me armëmbajtjen pa leje. Ndodh që në çastin që dikush kapet me armë, bëhet akti i ekspertimit lidhur me armën (nëse është apo jo armë, çfarë arme është dhe nëse është e aftë për të realizuar qitje). Këtë e bën eksperti përkatës dhe mbi bazën e kësaj, ngrihet ose jo, akuza për përgjegjësi penale. Eksperti përkatës i referohet këtij ligji, sepse dispozita e Kodit Penal është një dispozitë e bardhë.

Vetë ky kod nuk jep përkufizime. Pyetja që kam është: ky ligj sjell ndonjë gjë ndryshe nga ligji i mëparshëm në këtë kuptim? Pra, ekspertët që do të thirren nesër nga prokuroria për të përcaktuar nëse është apo jo armë, çfarë arme është dhe nëse është e aftë për të realizuar qitje dhe në fund të fundit, në masën 100% ky është akti që e ngarkon ose jo armëmbajtësin pa leje, me përgjegjësi penale, sepse pjesa tjetër është formale dhe nuk ka lidhje me thelbin e çështjes. Ky ligj sjell ndonjë gjë ndryshe nga ligji i mëparshëm? Nëse sjell, kjo duhet të reflektohet në punën e përditshme të ekspertëve që thirren dhe më pas, në punën e prokurorisë dhe të gjykatave. Mbi bazën e gjithë këtyre përkufizimeve, si ekspertë që jeni, për cilat kategori personat mund të mbajnë përgjegjësi penale? Për cilat armë pa leje, personat mund të mbajnë përgjegjësi penale?

Adriatik Ago – Sjell të reja sepse në raport me komentën që bëri zoti deputet, vetëm te Përkufizimet, duke filluar nga përkufizimi i parë që bën fjalë për armën në tërësi dhe më pas është arma e zjarrit dhe arma e qitjes. Këta bëjnë referenca për Policinë Shkencore dhe për problemet e procedimeve penale, në raport me klasifikimin e armëve. Dua t’ju bëj me dije që Policia Shkencore ka një manual të miratuar për sa i përket kritereve, në përputhjeve me direktivën, për të përcaktuar se cila është armë zjarri, cila është armë artizanale, cila është armë e prodhuar vetë dhe ka një manual me kritere të detajuara, për të përcaktuar nëse arma është në gjendje të rregullt teknike apo jo. Prandaj dhe ekspertët thirren në proceset penale, gjyqësore apo në prokurori dhe janë të legjitimuar për ta bërë këtë akt ekspertimi. Ne e shtojmë bazën ligjore për gjyqësorin dhe hetimin, për sa i përket klasifikimit të armëve pa leje. Pra, ky ligj jep akoma më shumë akses.

Ermonela Felaj – Të më falni se ne nuk jemi ekspertë të armëve, por gjithsesi për të ezauruar një shqetësim: te ligji aktual, është dhënë kuptimi i armës në nenin 3, ndërkohë që ju me shumë të drejtë dhe ne ju përgëzuam për këtë, e keni marrë dhe e keni përfshirë te përkufizimet. Po të krahasojmë përmbajtjen e ligjit aktual, me atë që keni sjellë, ka ndryshime të vogla që ka një lloj ndikimi.

Sipas ligjit të vjetër: “Armë” sipas këtij ligji konsiderohet, por nuk kufizohet... (pjesën “nuk kufizohet”, nuk e keni në përmbajtjen që keni sjellë), çdo mjet ose vegël e përgatitur me qëllim që, nën presionin e gazrave me presion, të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyes, elektricitetit, gazrave me presion, ose energjisë tjetër potenciale (edhe pjesën “energjisë tjetër potenciale” nuk e keni), të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë (deri këtu jemi njësoj), që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkaktuar dëm trupor fizik dhe psikologjik Jam dakord që e keni hequr “trupor”, sepse është e njëjta gjë me “fizik”), si dhe çdo mjet tjetër qëllimi i të cilit, është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit të njerëzve

ose pronës. (edhe këtë pjesën e fundit nuk e kemi). Mos është më i plotë përkufizimi te ligji i vjetër dhe është mirë ta marrim dhe ta vendosim këtu siç është?

Adriatik Ago – Përkufizimi që është në ligjin ekzistues është në variantin e ligjit kosovar. Me ekspertët e atashuar në Policinë e Shtetit, që kanë marrë pjesë shumë aktive në hartimin e këtij drafti, kemi aktualisht 3 përkufizime: një nga direktiva, një nga ligji i Kosovës dhe nga PE-ja, që ka bërë aderimin e vitit 2008. Na u sugjerua të vendosim përkufizimin e direktivës, e cila e përmbledh pavarësisht nga detajet në përmbajtje dhe është e njëjta gjë. Ne na pëlqen dhe e përmbush detyrimin për të reflektuar këtë direktivë.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Para se të kalojë në komisionin përgjegjës për shqyrtim, këshilltari të shikojë si e kishte ligji, si e ka direktiva dhe si e kemi ne, në mënyrë që t'ia kalojmë komisionin përgjegjës. Të shikojmë edhe shqipërimin e direktivës, sepse praktika e ka treguar që direktivat në disa raste, janë shqipëruar sipas ligj-shkruesve.

Atëherë, jeni dakord me sugjerimet, vërejtjet që u bënë? Këshilltarët do t'i reflektojnë së bashku me ekspertët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që janë të pranishëm, nën kujdesin e relatores dhe zonjës Hysi, për amendamentin që u bë për të dhënat personale dhe amendamentin për armët, me zotin Subashi dhe zonjën Felaj.

Atëherë, kush është dakord me projektligjin në tërësi?

Kundër? 3 vota kundër. Abstenim? S'ka.

Miratohet projektligji "Për Armët".

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 08.07.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Eduard Halimi dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Blendi Klosi, Tom Doshi, Silva Caka, Arben Ristani, Gent Strazimiri dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Adriatik Ago – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Arjan Selita – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Dhimitraq Ziu – përfaqësues i Ministrisë së Brendshme

Renata Palluci – përfaqësuese e Ministrisë së Brendshme

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

Cili nga përfaqësuesit e ministrisë do të bëjë një paraqitje në mënyrë të përmbledhur?

Shumë shkurt, sepse ne kemi përpara projektligjin, relacionin me komentet e relatores, kështu që është i njohur për ne. Dy fjalë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Adriatik Ago – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke u nisur nga analiza që i kemi bërë situatës konkrete dhe kërkesave të shumta të ardhura nga grupet e interesit, të biznesit, ndryshimeve të vazhdueshme që ka pësuar legjislacioni në tërësi dhe afatit të gjatë kohor të ligjit ekzistues, logjika na çoi që duhet të bënim një projektligj të ri për të rregulluar aktivitetin privat të sigurisë fizike. Ju bëj me dije se të rejat që sjell ky ligj janë:

- Përcaktohet për herë të parë certifikimi i shtetasve të huaj. Është dhënë e drejta e hapjes së biznesit në këtë veprimtari nga shtetasit e huaj, si një e drejtë e

veprimtarisë së ekonomisë së tregut të lirë, e cila në ligjin ekzistues ka qenë e mohuar, duke përcaktuar qartë edhe kushtet që duhen plotësuar nga aplikantët. Shtetasi i huaj duhet të jetë i pajisur me leje- qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, të jetë i pajisur me leje pune nga autoritetet shqiptare dhe t’i nënshtrohet kontrollit të besueshmërisë sipas ligjit në fuqi.

- Janë vendosur kritere dhe procedura më të qarta për sa i përket titullarit të subjektit, i cili në raport me ligjin ekzistues, përveç moshës duhet të ketë jo më pak se 5 vjet aktivitet në funksione menaxheriale. Kjo sjell që ai të mos e marrë licencën në moshën 18-vjeçare, por ta marrë në një moshë më të pjekur për drejtimin e këtij aktiviteti, i cili është edhe veprimtari ekonomike dhe financiare.

- E reja për drejtuesit teknikë është, që kur ky vjen nga radhët e Policisë së Shtetit dhe mban gradën minimale nën-komisar, nuk i nënshtrohet testimit. Kjo është për arsye se veprimtaria e shërbimit privat të sigurisë fizike është e ngjashme me veprimtarinë e Policisë së Shtetit në fushën e sigurisë.

- Është parashikuar për punonjësin e shërbimit ngritja e nivelit arsimor nga arsimi 8-vjeçar, në arsimin e mesëm dhe trajnimi i gjithë stafit të një kompanie të shërbimit privat të sigurisë fizike, do të bëhet pranë institucioneve të arsimit policor, aktualisht, pranë QFP (Qendrës së Formimit Policor).

- Një tjetër risi që sjell ky ligj, është kur punonjës i shërbimit është ish-punonjës i Policisë së Shtetit apo i strukturave të tjera ligjzbatuese, që janë me gradë policore, siç

është SHKB, Garda, SHISH-i, apo ushtria, edhe këta nuk do të kryejnë testin profesional, pra, merren të prezumuar për shkak të eksperiencës dhe njohurive që ne mendojmë se janë të mjaftueshme për kryerjen e shërbimit.

Zoti kryetar,

Janë riformuluar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Këto janë të rejat që sjell ky ligj dhe ne mendojmë se ligji do të sjellë një impakt në drejtim të sigurisë publike, që ky shërbim të bëhet pjesë e strukturave të sigurisë publike, për garantimin e saj në vendin tonë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori i komisionit për këtë projektligj, zoti Lutaj!

Piro Lutaj – Faleminderit!

Duke mos përsëritur ato që thanë përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, duhet t'ju them se ligji vjen në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Në thelb ligji që po miratojmë, shfuqizon ligjin e vitit 2001, që ka të bëjë me shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike dhe ka disa risi:

Janë vendosur kriteret dhe procedura më të qarta, që duhet të plotësojnë aplikuesit për certifikatë apo licencë, duke bërë të shmanget monopolizimi i këtij lloji shërbimi nga 3-4 firma ose shoqëri, që veprojnë dukshëm në Shqipëri nëpërmjet nënkontraktorëve, të cilin ligji që po paraqesim sot, e shmang.

Gjithashtu, janë përcaktuar qartë kriteret dhe standardet në lidhje me aftësitë personale e profesionale që duhet të plotësojnë në mënyrë specifike aplikuesit për certifikim, me qëllim shmangien e nivelit të ulët të njerëzve, të cilët kanë pasur rastin të administrojnë këto shoqëri. Për arsye se ky shërbim është ngritur në një nivel të konsiderueshëm. Ky shërbim është në aeroport, nëpër porte dhe kështu që, kërkohet përsosmëria e legjislacionit, me qëllim që edhe përzgjedhja e njerëzve, t'i përgjigjet nivelit të zhvillimit të shoqërisë.

Siç e thashë, kemi objeksionet tona lidhur me 2-3 dispozita të këtij ligji, për të cilat do të diskutojmë gjatë shqyrtimit nën për nen.

Kryesisht kam vërejtje për nenin 11, ku nuk përcaktohet detyrimisht arsimi i lartë i personit, i cili do të aplikojë për licencë. Dua të ndaj bashkërisht një shqetësim këtu: Përderisa i jepet prioritet në çdo rast punonjësit të policisë, unë do t'iu sugjeroja që krahas tyre t'u jepni prioritet edhe punonjësve që kanë punuar në Forcat e Armatosura, sigurisht konform të gjitha detyrimeve të tjera. Mendoj që vendosja e prioritetit të posaçëm vetëm për punonjësit të policisë, u privon të drejtën personave që kanë punuar në strukturat e

tjera, siç janë punonjësit që kanë punuar në Forcat e Armatosura, që për mendimin tim janë mjaft të përshtatshëm për ta kryer më së miri këtë aktivitet.

Lidhur me vendin ku do të kualifikohen këta persona flet neni 21 dhe është përcaktuar Instituti i Policisë.

Do t'ju sugjeroja që këtu të përfshihen edhe institucionet private, të cilat licencohen si të tilla nga Ministria e Arsimit dhe ministri i Punëve të Brendshme dhe sigurisht, nëse shoqëria do të trajnohet në këtë institucion apo jo, i mbetet atribut i drejtorit të Përgjithshëm, i cili pajis shoqërinë me licencën përkatëse. Këto do të diskutohen gjatë shqyrtimit nën për nen, prandaj, ju ftoj ta miratojmë në parim!

Fatmir Xhafaj – Në cilat nene dëshironi të ndaleni më shumë?

Piro Lutaj – Kam komente për nenet 10, 11 dhe 21.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Lutaj!

Këshilltarët të jenë të vëmendshëm kur të arrijmë te këto nene!

Kalojmë në pyetjet!

Kush do të bëjë pyetje për përfaqësuesit e ministrisë?

Zoti Subashi, keni fjalën!

Armando Subashi – Pyetja ime ka të bëjë me një detaj që është i lidhur edhe me ligjin “Për armët”, që sapo miratuam. Nisur edhe nga ajo që shikojmë çdo ditë, lidhur me këto subjektet private apo policitë private, siç quhen në gjuhën popullore, këta punonjësit e shërbimit, që këto subjekte rekrutojnë, janë të lloj-lloj historive, të moshave të ndryshme, të aftësive fizike nga më të ndryshmet. A parashikon ky ligj kriteret kufizuese për këtë pikë? Të mos harrojmë që këto subjekte shpeshherë, marrin detyra shumë të rëndësishme. Ruajnë institucione qendrore, ruajnë banka, objekte me rëndësi të veçantë e shpesh herë, depo armatimi, depo dinamiti, depo me rrezikshmëri toksike dhe sigurisht, që personi apo subjekti që ka marrë licencën mund t'i ketë plotësuar të gjitha kushtet, por kur vjen puna te personi i thjeshtë që bën roje *de facto*, shikojmë çudira. Kështu që, a ka parashikuar ligji kriteret kufizuese në këtë drejtim dhe duke e lidhur me ligjin që sapo kaluam, a keni vënë ndonjë kusht që të paktën ta bëjnë trajnimin në poligone civile, sepse ajo lidhet me armët B1, B4, C etj.?

Adriatik Ago – Është pikërisht situata e rënduar në radhët e këtyre kompanive që deri sot kanë bërë rekrutime të pakontrolluara në lidhje me kriteret e ligjit dhe u është dhënë mundësia të rekrutohen edhe njerëz të papërshtatshëm. Një nga mënyrat që kemi menduar, për t'i minimizuar këto raste dhe për të rifreskuar efektivat e këtyre shërbimeve, është ajo që vendosëm (këtu po i kthej përgjigje edhe zotit Lutaj), në raport me projektligjin që sapo kaluam, ku kishim liberalizuar të drejtën e trajnimeve, kemi

arsyetuar që e drejta e trajnimeve, do të mbetet monopol i arsimit policor. Vetëm kjo është rruga që të eliminojmë të paaftët, për arsye se Qendra e Trajnimeve dhe Akademia e Policisë është struktura e vetme sot te ne, që merret me edukimin profesional. Është e padiskutuar që funksionon qendra e trajnimit dhe ne i kemi paraprirë me programe dhe me staf të ri pedagogjik.

Fatmir Xhafaj – Kush tjetër do të bëjë pyetje për përfaqësuesit e ministrisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Adriatik Ago – Të gjithë do të kalojnë në Akademinë e Policisë, në Qendrën e Formimit Policor për të marrë dëshminë. Edhe drejtuesit teknikë edhe dëshmia e punonjësit konkret dhe e qytetarit.

Fatmir Xhafaj – Do ta shikojmë te neni përkatës.

Zoti Frroku, keni fjalën!

Mark Frroku – A është vendosur një kriter për moshën e këtyre personave që bëjnë shërbim, sepse po shikojmë që në Policinë e Shtetit po vendoset një kriter për moshën?

Adriatik Ago – Duke qenë se ky aktivitet është një aktivitet ekonomik, ku punësohen njerëzit, në raport me të drejtën kushtetuese, nuk kemi vendosur moshë minimale. Domethënë 18 vjeç është një person normal i trajnuar, që kryen detyrën e punonjësit të shërbimit. Kemi vendosur kriter për të licencuarin, për subjektin dhe për drejtuesin teknik, ndërsa për punonjësin e shërbimit, s'ka kuptim.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Ai nuk parashikon rastet, kur shkelet ligji. Ai thotë që ligji e ka kështu. Zoti Fufi, keni fjalën për pyetje!

Mhill Fufi - Faleminderit, zoti kryetar!

Duke parë se armët luftarake si “Kallashi” dhe TT-ja kanë dalë jashtë përdorimit me këtë ligj, ku do t'i marrë armët pronari i kompanisë? Do t'i marrë nga shteti, apo do t'i marrë me leje vetë subjekti, që merret me shërbimin privat të sigurisë fizike?

Fatmir Xhafaj – Subjekti që merret me shërbimin privat të sigurisë fizike...

Deputeti Fufi ka një pyetje: ku do t'i blejë armët shoqëria?

Mhill Fufi – ...ose do t'i marrim nga shteti?

Fatmir Xhafaj – Në rregull, e bëtë pyetjen. Cila është përgjigja, zoti Ago?

Adriatik Ago – Kjo është risia e dy ligjeve që sapo kaluam. Është risia e liberalizimit të së drejtës së pronësisë dhe në ligjin aktual çdo njeri që do të ushtrojë aktivitete të tilla do të shkojë ta blejë në tregun e lirë, gjithmonë nën licencën e dhënë me kontroll të rreptë nga policia, nga autoriteti i sigurisë publike, nga Policia e Shtetit. Pra, sot

e tutje, me miratimin e këtij ligji nuk do të jetë më Policia e Shtetit distributor për të shpërndarë armët në shoqërinë civile. Ne kemi liberalizuar të drejtën e pronësisë dhe Policia e Shtetit, Ministria e Brendshme do të jenë kontrollori, regjistruesi, konstatuesi, autorizuesi dhe respektuesi i ligjit në rastet e konstatimit të shkeljeve në këtë fushë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Kam unë një pyetje. Një punonjës policie që ju thoni të bëhet drejtues teknik e të tjera, që është përjashtuar nga Policia e Shtetit për shkelje të rënda në detyrë, për arsye nga më të ndryshmet, jo për ristrukturime nga këto, se këto nuk bëjnë sens, por për shkelje të rënda të figurës së punonjësit të policisë është dënuar, a mund të jetë? A duhet të keni vendosur ndonjë parashkrim?

Adriatik Ago – Procesi i verifikimit nëpërmjet besueshmërisë që ky ka...

Fatmir Xhafaj – Besueshmëria është fjalë shumë subjektive.

Adriatik Ago – Në qoftë se ky person është përjashtuar nga Policia e Shtetit për shkelje të rënda të kriterëve të ligjit, me përjashtim të rasteve të dënimeve me vendim të formës së prerë, kur ky ligj nuk e lejon të rekrutohet në shërbimin...

Fatmir Xhafaj – Pse? Në cilin nen thuhet se nuk e lejon?

Adriatik Ago – Në rastet e dënimeve me vendim të formës së prerë, kurse kur është përjashtuar, ai është subjekt dhe kompania mund ta rekrutojë pasi të vijë në QFP të marrë dëshminë për t'u bërë...

Fatmir Xhafaj – Është drejtues teknik ai.

Adriatik Ago – ...drejtues teknik ose punonjës shërbimi. Pra, ai do t'i nënshtrohet tërësisht dokumentacionit dhe është një njeri që nuk përmbush kriteret. Është e drejta e punësimit që ne nuk mund ta kufizojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Kur të vijmë te dispozita përkatëse, se kjo nuk bën sens tani: për trafik dhe i thua pastaj: shko, bëj atje të ruash paratë e shtetit. Mos, o Zot!

Ka pyetje? Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Më falni, unë kam një pyetje: a i keni parashikuar në projekt rastet e konfliktit të interesit? Për shembull, kur punonjës që janë pjesë e Policisë së Shtetit kanë shoqëri të ruajtjes fizike, natyrisht jo në emrin e tyre, por të të afërmeve, se kemi raste të tilla në praktikë.

Fatmir Xhafaj – Po, edhe ky është një problem.

Adriatik Ago – Është e sanksionuar në këtë ligj.

Ermonela Felaj – Në cilin nen?

Adriatik Ago – Te “Përrjashtimet”: “Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Brendshme, të strukturave të Policisë së Shtetit, të Gardës, të Ushtrisë, të cilët janë punonjës aktivë, nuk u lejohet të përfshihen në këtë aktivitet.”

(Deputetja Felaj flet pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – ...duhet ta parashikoni këtë në mënyrë të shprehur. Shoqëritë e ruajtjes fizike të mos jenë ekskluzivitet i atyre që kanë qenë ose që sot janë në Policinë e Shtetit, sepse, duke qenë brenda në Policinë e Shtetit, e kanë shumë të lehtë të certifikohen dhe të licencohen. Përveç të tjerash, kështu krijojnë pabarazi. Ndaj mendoj se në ligj duhet të kemi një dispozitë të shprehur për të shmangur rastet e konfliktit të interesit.

Fatmir Xhafaj – Besoj se të dyja vërejtjet që u bënë, do t’i shikojmë nen për nen, edhe përjashtimet e të gjithë atyre që janë përjashtuar nga Policia e Shtetit për këto motive që thamë dhe rastin e konfliktit të interesit, sepse kjo është gati-gati ligësi. Po e them paraprakisht se pothuajse një pjesë e mirë e shoqërive të ruajtjes fizike kanë lidhje të drejtpërdrejta me titullarë dhe eksponentë të Policisë së Shtetit.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim.

Vazhdojmë nen për nen.

Neni 1. Biem dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 2 “Objekti i ligjit”.

(Diskutime në sallë.)

Kolegë, ju lutem, ndiqeni!

Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizimet”. Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Parime të përgjithshme”.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, te neni “Parimet e përgjithshme” nuk gjej asnjë parim mbi të cilin duhet të funksionojë shërbimi i sigurisë fizike. Ju këtu keni thënë vetëm cilës procedure ose cilit ligj i nënshtrohen subjektet e shërbimit të sigurisë fizike. Do t’ju lutesha që parimet të jenë shprehimisht, duke filluar nga parimi i ligjshmërisë, që e thamë, parimi i profesionalizmit, i shmangies së konfliktit të interesit, i respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, sepse

këto lloj shërbimesh veprojnë si Policia e Shtetit, apo jo? Parimet që ka Policia e Shtetit mund të merren këtu, duke shtuar edhe shqetësimin që ne kemi.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ago.

Adriatik Ago – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, biem dakord me vërejtjet dhe sugjerimin?

Miratohet neni 4.

Neni 5 “Certifikimi”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Te neni 5 kam dy shqetësime, një për paragrafin e pestë dhe një për gjashtën. Ju thoni se certifikata e titullarit dhe e drejtuesit teknik është e vlefshme për katër vjet me të drejtë ripërtëritjeje për titullarin e subjektit, ndërsa për drejtuesin dhe punonjësit është pa afat. Pyetja ime qëndron: nëse kemi vënë disa kriteret për të vlerësuar aftësinë mendore, fizike, aftësinë për të mbajtur armë, për ta përdorur, si mund t’ia lëmë pa afat drejtuesit teknik dhe punonjësit të shërbimit? Sugjeroj të ketë afat, madje është e detyrueshme që ata të kontrollohen për aftësitë fizike, mendore, psikologjike, sepse për një person, që mund të ketë një traumë ose mund të sëmuret, nuk mund të jetë pa afat.

Armando Subashi – Duhet të jetë e kundërta.

Vasilika Hysi – Unë jam që si për titullarin, për drejtuesin teknik dhe punonjësit e shërbimit, kontratat të jenë me afat. Duhet verifikuar se janë persona të cilët kanë përgjegjësi dhe përdorin armë.

Fatmir Xhafaj – Dakord?

Adriatik Ago – Dakord.

Vasilika Hysi – Shqetësimi tjetër lidhet me pikën 6. Ju thoni se përbërja e të dyja komisioneve dhe procedurat duhet të rregullohen me udhëzim të ministrit.

Do t’ju lutesha, kolegë të ministrisë, që përbërja, procedurat ose parimet e përgjithshme të shqyrtimit të kërkesave, të certifikimit dhe të licencimit duhet të jenë në ligj. Nuk mund të lihen me udhëzim të ministrit. Janë gjëra shumë të rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Përbërja dhe procedurat.

Vasilika Hysi – Të paktën përbërja e komisionit duhet të jetë... nuk them emrat, se emrat i përcakton ministri, por fakti që në këtë komision duhet të jenë njerëz që nuk kanë konflikt interesi, ku njëri prej anëtarëve të komisionit nuk mund t’i japë licencë vëllait, motrës, kunatit, kunatës ose personi të cilit i refuzohet leja, ka të drejtë të dëgjohet dhe të marrë argumentet, kjo është e domosdoshme. Kam edhe një sugjerim të rasti kur flitet për refuzimin e kërkesës.

Adriatik Ago – Ne kemi arsyetuar se për teknikën legislative po të futemi në detaje do të dalim jashtë logjikës së ndërtimit të nenit. Janë detajime...

Fatmir Xhafaj – Këto janë kushte.

(Diskutime në sallë.)

Adriatik Ago – Ne kemi thënë se për përbërjen e komisioneve dhe procedurat të rregullohen me akt normativ të ministrit përgjegjës, në rastin konkret, të ministrit të Brendshëm, sepse janë shumë të detajuara, shumë të gjata.

Fatmir Xhafaj – Procedurat po, por...

(Deputetja Felaj flet pa mikrofon.)

Adriatik Ago – Në qoftë se keni mendim ndryshe, biem dakord, por nuk na prish gjë në veprimtarinë tonë të përditshme.

Fatmir Xhafaj – Koleg tjetër? Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Në fakt, unë shkoj drejt të njëjtës linjë me zonjën Hysi. Nëse ne vëmë parime dhe themi se nuk duhen dhënë certifikata, licenca në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo do të ngelet si dogmë në qoftë se nuk ndërhyjmë te komisioni. Ta prish gjithë punën komisioni. Prandaj, të paktën si numër, si përbërje, titullarë të kujt institucioni brenda Policisë së Shteti, po themi do të jenë këta, dhe si parim çfarë do të përfaqësojnë këta njerëz? Këto duhet t'i jepni. Pastaj, gjëra të tjera natyrisht nuk nevojiten, por në përgjithësi këto duhen dhënë.

Ne kemi edhe ligje të tjera. Kemi të gjitha ligjet që rregullojnë licencimin dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, organet që licencojnë ose lejojnë janë të dhëna në ligj. Nuk lihen të detajohen nëpër akte të tjera nënligjore që për më tepër u mungon transparenca, sepse nuk janë të hapura për publikun.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me vërejtjet për nenin 5?

Adriatik Ago – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Licencimi”. Ka pyetje?

(Deputetja Felaj flet pa mikrofon.)

Adriatik Ago – Sot këtë e ka zgjidhur teknologjia. Ne japim dhe marrim nëpërmjet e-mailëve.

Vasilika Hysi – Është publike?

Adriatik Ago – Është publike në internet, e hapur për të gjithë. E ka zgjidhur ligji i licencave dhe QKR-ja.

Armando Subashi – Në pikën 3 thoni: “Licenca është e vlefshme për katër vjet.” Pse vihet afat dhe pse licenca të mos jetë pa afat? Për sa kohë që unë vazhdoj të përmbush kriteret ligjore, unë vazhdoj të kem licencën.

(Diskutime në sallë.)

Thotë: “Licenca e subjektit”. Pra, licenca që unë marr për polici private është katër vjet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Adriatik Ago – Këtu nuk ka asnjë motiv tjetër. Problemi shtrohet që për një njeri të rregullt që është brenda normave të ligjit, ajo ricertifikohet pa asnjë pengesë, por periudha katërvjeçare lidhet me një kontroll të besueshmërisë.

Fatmir Xhafaj – Kjo është veprimtari tregtare biznesi dhe ju nuk mund të ndërhyni t’ia ndërprisni veprimtarinë tregtare drejtuesve teknikë. Në qoftë se ky kërkohet në të gjitha, kërkohet në një kohë që ai ta rinovojë herë pas here se mund të humbasë shikimin, mund të ketë probleme fizike, është tjetër gjë, por licenca tregtare është për veprimtari tregtare. Ju nuk mund t’i thoni sot: ndërprite katër vjet veprimtarinë tregtare dhe hajde edhe një herë te mua e të tjera. Kollitu edhe një herë atje lart.

Biem dakord? Hiqini fjalët “pa kufizim”.

Dakord pa afat licenca?

Adriatik Ago – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Pastaj, po nuk plotësuan kushtet, t’u hiqet licenca, është tjetër gjë, mund t’ia heqësh që mbas gjashtë muajsh. Kontrollloje, bëje...

Biem dakord me nenin 6 me vërejtjen që iu bë?

Miratohet.

Neni 7 “Kategoritë e licencës”. Ka vërejtje ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “E drejta e përfitimit njëkohësisht të nënkategorive të licencës”. Këto janë aq teknike saqë..

Biem dakord? Dakord.

Miratohet.

Neni 9 “Llojet e certifikatave”. Ka vërejtje, sugjerime ose propozime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Fjalën e ka zoti Lutaj.

Piro Lutaj – Në pikën 1 të nenit 10 mendoj se duhet vendosur në mënyrë të posaçme edhe kërkesa për arsimin e lartë. Pra, themi: “të ketë arsimin e lartë, zotësi të plotë juridike për të vepruar...” e të tjera. Është e padiskutueshme për arsye se te neni 11

drejtuesit teknik ia kemi kërkuar këtë. Kështu që të përcaktohet arsimi i lartë, sepse njerëz që nuk dinë të shkruajnë as emrin e tyre na janë bërë drejtues të mëdhenj ose, çfarë quhen, titullarë. Këtë kam për nenin 10.

Fatmir Xhafaj – Pra, të shtohet arsimi.

Piro Lutaj – Në pikën 1 të nenit të shtohet arsimi i lartë. Pra, të riformulohet kështu: “të ketë arsimin e lartë, zotësi të plotë...” e të tjera. Vetëm të shkruhen fjalët “arsim i lartë”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të paktën t’ia kërkojmë që të shkojë të paguajë ca lekë që ta blejë.

Nuk është për roje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është ashtu.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Kruja.

Keltis Kruja – Zoti kryetar, për sa kohë ka përkufizime dhe kritere për drejtuesin teknik, i cili është realisht drejtuesi i shoqërive, po flasim në aspektin operacional, jo në aspektin e veprimtarisë, unë nuk mendoj se ne mund t’i kufizojmë pronarit të drejtën për të bërë biznes se nuk ka shkollën e lartë. Tani po e kthejmë në...

(Deputetja Felaj ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund t’ia kufizosh me shkollë të lartë ose jo, ai ka të drejtën e tij të bëjë biznes. Kaq. Drejtuesi teknik po, duhet të ketë kritere të përcaktuara dhe i ka.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Prenga. Ju lutem, me mikrofon!

Armando Prenga – Të them të drejtën, jam me mendimin e zotit Kruja. Ne kemi shumë biznesmenë tregu me shkollë të mesme dhe drejtuesit normalisht janë juristë, ekonomistë e të tjera.

Keltis Kruja – Ne nuk mund të kufizojmë asnjë pronar që të jetë pa shkollë të lartë.

Fatmir Xhafaj – Pa shkollë të mesme.

Keltis Kruja – Të paktën të shkojnë me arsim të mesëm.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me sugjerimin që t’i vendosim arsimin?

Fjalën e ka zoti Frroku.

Mark Frroku – Ne jemi ekonomi tregu dhe nuk mund të ndalojmë njeri të bëjë biznes. Ai mund të jetë edhe me dy klasë shkollë, ai duhet të bëjë biznes, pra nuk duhet të ketë kufizim në mënyrën më absolute. Jemi në ekonomi tregu.

(Diskutime në sallë.)

Unë kështu e mendoj. Nuk duhet të ketë kufizime në mënyrën më absolute. Çdo njeri ka të drejtë të bëjë biznes, me shkollë, pa shkollë.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord “me të mesme”?

Dakord me nenin 10.

Neni 11. Këtu te drejtuesit teknikë besoj se arsimin do ta vendosim, apo jo?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 11 për kriteret e certifikimit të drejtuesit teknik, unë jam për të përforcuar kriteret.

E para, personi duhet të jetë me arsim të lartë.

E dyta, sugjeroj që germa “dh” të ndryshojë. Pra, të thuhet: “Personi që do të punojë, që do të certifikohet si drejtues teknik të mos ketë qenë i dënuar më parë me vendim të formës së prerë për vepra penale”, sepse ne ia kemi kërkuar titullarit për vepra penale, ndërsa këtu themi “për vepra penale me dashje”.

Jo, zotëri, ajo është vepër penale, si me dashje dhe pa dashje. Ai është personi më i rëndësishëm të cilit ne i japim të drejtën të bëjë bankat, pasuritë, të sigurojë personat, shtetasit. Pra, çdo lloj vepre penale.

Ermonela Felaj – Kuptohet, të mos ketë qenë i dënuar.

Vasilika Hysi – Pra, të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë. Madje, unë do të isha edhe më kërkuese lidhur me personat që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, që të mos jenë në hetim, pra që të jenë akuzuar për vepra penale.

Gjithashtu, te germa “ç” ju thoni: “të ketë mbajtur gradën policore të nivelit të parë drejtues ose të ketë arsimin e lartë ushtarak, si dhe të ketë përfunduar trajnimin...”. Jo trajnimin. Ai mund të ketë një trajnim profesional fillestar, por do të ketë edhe trajnime vazhduese. Nuk mund ta lëmë personin me një trajnim, “...trajnimet profesionale në fushën përkatëse.”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam për redaktimin. Nuk thuhet “organizohet...” se i bie të bëjmë leksion pastaj.

Fatmir Xhafaj – Kam një merak për të shtuar atë, që të ndalohet në qoftë se është përjashtuar nga Policia e Shtetit, pra rastet e përjashtimit janë dy-tri herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Armando Subashi – Ajo duhej vënë edhe te neni 10.

Fatmir Xhafaj – Është Ulsi këtu relator.

Armando Prenga – Jam i mendimit që këtu të shtohet edhe dëshmia e penalitetit, edhe certifikata e personalitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Certifikatën e personalitetit nuk mund ta marrësh dot po nuk...

E merr në komisarjat, në Drejtorinë e Policisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po, duhet ta marrin.

Fatmir Xhafaj – Ka certifikatë personaliteti? Atëherë, të shënohen këto.

Armando Prenga – Vërtetim personaliteti quhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ajo është shumë subjektive, kurse kjo është krahas asaj bëj edhe besueshmërinë tjetër, që ky ka këtë, këtë dhe këtë, por ka një problem me besueshmërinë. Dakord? Se mund të jetë një çështje, për shembull, personi është në ndjekje e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse? Ju lutem, me mikrofon!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dhimitraq Ziu – Vërtetimi i personalitetit është një dokument i cili e ka bazën ligjore se kur dhe përse lëshohet, dhe kjo është pjesë që ne e kemi vendosur në procesin e verifikimit të besueshmërisë. Kur ne themi “për besueshmëri” e ka brenda vërtetimin e personalitetit.

Fatmir Xhafaj – Dakord, po një i përjashtuar për vepra të rënda penale nga policia nuk mund të jetë këtu, as këtu, as te këto të tjerat.

Dakord, Bledi?

(Këshilltari i komisionit shprehet dakord.)

Për të gjitha këto: 11-tën, 12-tën...

Ermonela Felaj – Te 12-a të kihet parasysh mosha.

Fatmir Xhafaj – Por përveç kësaj do të përfshihet kush është përjashtuar nga Policia e Shtetit, nga Forcat e Armatosura për vepra... për përkufizimin që është atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka lidhje me ato. Unë po flas për trafik e për të gjitha këto. Dakord?

Po, zoti ...

Dhimitraq Ziu – Ne nuk përdorim rastet e përjashtimit nga Policia e Shtetit. Për të qenë të qartë, rastet e përjashtimit si masë ekstreme nga Policia e Shtetit janë të përcaktuara në Rregulloren e Disiplinës.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, do t’i marrim nga rregullorja dhe do t’i vendosim.

Dhimitraq Ziu – Dhe të gjithë këto grup-rastesh që i përmendni, ne i kemi klasifikuar si raste ngjarjesh të rënda.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Dhimitraq Ziu – Kur ka probleme të tilla për figura krimi, ato i nënshtrohen hetimit dhe Kodit Penal.

Fatmir Xhafaj – Është tjetër gjë figura e krimit.

Dhimitraq Ziu – Në këto kontekste nuk mund ta vendosim në ligj “përfjashtimi për këtë, këtë dhe këtë”. Ne themi se është përfjashtuar sipas Rregullores së Disiplinës. Duhet që të mos rekrutohet...

Fatmir Xhafaj – Nuk e ke fare kur ka...

Dhimitraq Ziu – Dakord pra. Të mos rekrutohet kur ai është i përfjashtuar nga Policia e Shtetit me masën maksimale disiplinore.

Fatmir Xhafaj – E rëndësishme është që në këto të dyja të futen këto.

Dhimitraq Ziu – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ai tani është përfjashtuar për dhunë në Policinë e Shtetit ndaj qytetarëve dhe ti thua: “Do të shkojë të shërbejë këtu” që të rrahë aty më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë tani, se ka një kufi kjo gjë!

Duhet të dini një gjë që ta kuptoni. Këto janë disa profesione, siç është avokati, që rregullohen dhe një pjesë të përgjegjësisë në raport me qytetarin e mban shteti. Pse e mban shteti? Sepse shteti të licencon. Shteti të kontrollon. Shteti të trajnon. Për të gjitha këto arsye, shteti ka edhe një përgjegjësi me qytetarin, se nuk është si çdo gjë në treg. Për shembull, është një tregtar i zakonshëm në treg. Nuk e ka përgjegjësinë shteti që kur vete ai të blejë atje, pse e blen te ky dhe pse nuk e blen te ky tjetri. Ndërsa te ky është një profesion që ka disa cilësi të veçanta, vërtetimin e të cilave e bën shteti. Shteti duhet të mbajë dhe të vendosë disa kufij për këto përgjegjësi që merr ndaj qytetarit, sepse me këtë rast qytetari është në besueshmërinë e shtetit. Është në besimin e shtetit dhe e ka marrë të mirëqenë. Thotë: këtë e ka licencuar shteti. Këtë e trajnon shteti. Këtë e kontrollon shteti. Pra, shteti ka detyrimin që t’ia garantojë këtë qytetarit për efekt të besimit të veçantë që ka dhe cilësive të veçanta të punës që ka.

Neni 11. Dakord me sugjerimet që u bënë.

Neni 12. Krahaz propozimeve...

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë. Drejtuesi teknik duhet të ketë ndonjë moshë minimale? Nuk e kam shumë të qartë kur mund të marrë gradën policore të nivelit të lartë.

Armando Subashi – Zonja Hysi, po e ka marrë gradën, mbaroi filmi.

Vasilika Hysi – Po pra, nuk e kam të qartë. Kur mund ta marrë gradën policore të nivelit të lartë?

Fatmir Xhafaj – Kur ka mbaruar arsimin e lartë.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ne kemi përvojë tetë vjet të opozitës së sotme. Kur kanë qenë maxhorancë, gradën e nivelit të parë e morën pa shkollë fare, direkt sa u bënë punonjës policie.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Dhimitraq Ziu – Për drejtuesit teknikë, fakti që i kemi vënë kriteret për të pasur arsim të lartë, moshën e ka të prezumuar. Pra, presumohet që mosha lidhet me arsimin e lartë si minimalja.

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Kur ai vjen nga radhët e policisë, bëhet fjalë që është me arsim të lartë se ka gradën minimale “Nënkomisar” dhe mosha përsëri është brenda që ai është mbi 21 vjeç. Për radhët e tjera ne e kemi me arsim që po përsëri është mbi 18 vjeç.

Fatmir Xhafaj – Jo, nuk ka asnjë arsim tjetër. Ligji e ka të qartë. Ai duhet të ketë mbajtur gradë që ta marrë.

Dhimitraq Ziu – Kur vjen nga radhët e Policisë së Shtetit ose nga ushtria.

Armando Subashi – Ose arsim ushtarak.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Një minutë! Që ai të certifikohet për drejtues teknik duhet të plotësojë 6 pika dhe me gjithë atë që shtuam 7 pika, apo jo? Në qoftë se ai nuk ka një nga këto, nuk certifikohet.

Dhimitraq Ziu – Po patjetër.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, e ka të detyrueshme të ketë gradën policore të nivelit të parë drejtues ose të ketë arsimin e lartë ushtarak. E ka të detyrueshme. Nuk është “ose”. Kështu e kemi lënë në ligj, zotëri! Pra, në qoftë se unë dëshiroj të kem certifikatën e drejtuesit teknik të këtij shërbimi, duhet të plotësoj këto shtatë pika dhe këto janë të detyrueshme të shtata; jo njërin nga këto ose edhe këtë.

Dhimitraq Ziu – Jeni te pika 2 e nenit 12, zoti kryetar, se nuk po ju ndjek dot?

Fatmir Xhafaj – U rikthyem te pika 1 e nenit 11.

Edhe te pika 1 e nenit 12 këto nuk janë “ose/ose”. Këto janë kushte që duhet t’i plotësojë detyrimisht të gjitha bashkë. Është e thjeshtë kjo, është e qartë.

Dhimitraq Ziu – E qartë është.

Fatmir Xhafaj – Jemi okej, nuk kemi pse t’i vëmë moshë kur ai e ka plotësuar këtë, ka marrë gradën e të gjitha.

Armando Subashi – Të bëj një pyetje këtu: “ose arsimin e lartë ushtarak”.

Pra, presupozohet se një person, i cili sapo mbaron arsimin e lartë ushtarak, sapo diplomohet, mund ta ushtrojë këtë aktivitet pa pasur asnjë ditë punë në Forcat e Armatosura. Ky që ka marrë gradën “Drejtues i nivelit të parë” presupozohet se i ka kaluar shkallët e profesionit për disa kohë, ndërsa ky sa diplomohet, menjëherë mund të fillojë këtu.

Dhimitraq Ziu – Personi që ka mbaruar një arsim të lartë ushtarak, po të marrim përshkrimet e punës, ditën e parë që diplomohet, i jepen përgjegjësi dhjetë herë më të larta në raport me detyrën e drejtuesit teknik. Është e prezumuar kjo, nuk bëhet fjalë fare për ta bërë.

Armando Subashi – Në rregull.

Dhimitraq Ziu – Me arsim të lartë ushtarak çojmë përfaqësitë tona ndërkombëtare...

Fatmir Xhafaj – Neni 11. Dakord.

Neni 12 “Mosha”.

Vasilika Hysi – Në fakt, kam një pyetje: a kemi ne punonjës policie qoftë në Gardë ose në pjesën tjetër të Policisë së Shtetit që punojnë 18 vjeç? Nëse po, dakord, por, nëse nuk ka, unë jam për ta rritur moshën. Nuk mund ta lëmë 18-vjeçarin të na ruajë bankat, prokuroritë ose gjykatat, arkivin, se ne sigurinë fizike, edhe institucionet e rëndësishme i kemi lënë pas orarit zyrtar me polici private.

E dyta, për germën “e” kërkoj të jetë “të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për çdo lloj vepre penale”. Prandaj këto janë dy shqetësimet e mia.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Po, zoti Ago.

Adriatik Ago – Në Policinë e Shtetit nuk ka punonjës në moshën 18 vjeç, por ne kemi vendosur se ndoshta mosha 18 vjeç është moshë kushtetuese, me Kodin e Punës, zgjidhen deputetë, ka të drejtën për të zgjedhur dhe është problemi i së drejtës së punësimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Adriatik Ago – Ju e keni në dorë, vendosni...

Fatmir Xhafaj – Kur shkonin paraushtarët që vinin në Gardë, sa vjeç ishin?

Adriatik Ago – 18 vjeç.

Fatmir Xhafaj – 18 vjeç kanë qenë në Gardën e Republikës?

Adriatik Ago – Dhe nëpër detyra me përgjegjësi shumë të mëdha.

Fatmir Xhafaj – Shkojnë ushtarë në Irak?

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Adriatik Ago – 18 vjeç do të shkojë atje ku ka vendin e trajnimit dhe për të marrë dëshminë.

Fatmir Xhafaj – Germa “a”: “Të ketë kryer në qendrën e trajnimit kursin e nevojshëm profesional”. Është në rregull. Ai vërtet ka vënë kufirin 18 vjeç, por i ka thënë edhe këtë. Ai në shkollë nuk e merr po nuk pati 18 vjeç, ndaj vetvetiu shkon edhe atje.

Dakord.

Kemi gjë tjetër për këtë?

Neni 12 me sugjerimin.

Armando Subashi – Nuk jam dakord të hiqet fjala “me dashje”.

Ermonela Felaj – Duhet hequr.

Armando Subashi – Më falni, një minutë, për shembull, ai ka bërë një aksident në rrugë dhe nuk punon dot rojë atje?!

(Deputetja Felaj flet pa mikrofon.)

Pse është nga pakujdesia, nuk do të thotë se është i papërgjegjshëm. Ç’domethënë kjo tani?

Ermonela Felaj – E ke gabim.

Armando Subashi – Kur e ka bërë me dashje, po.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me nenin 12?

Dakord.

Neni 13 “Certifikimi i shtetasve të huaj”. Ka vërejtje ose sugjerime?

Dakord.

Neni 14 “Kriteret për licencim”. Dakord.

Neni 15 “Refuzimi për dhënien e certifikatës”.

Ermonela Felaj – Ta korrigjoj këtë shprehjen “refuzimi i kërkesës për pajisjen bëhet me vendim”, sepse nuk mund të themi “vendimi bëhet me vendim”.

Fatmir Xhafaj – Si?

Ermonela Felaj – Këtu është thënë: “vendimi i refuzimit të kërkesës për pajisje bëhet me vendim”. Nuk shkon “vendimi bëhet me vendim”.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord?

(Specialistët shprehen dakord.)

Është teknike.

Neni 15. Keni edhe ju?

Vasilika Hysi – Unë kam një sugjerim. Ne themi këtu se kriteret e licencimeve i kemi përcaktuar. Nuk themi rastet e refuzimit, por ia kemi lënë drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të japë një vendim. A mund të jetë transparente në ligj se në cilat raste mund të refuzohet dhënia e certifikatës, qoftë edhe me një paragraf që certifikata ose licenca mund të refuzohen në rastet kur nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në këtë nen të ligjit? Ky është shqetësimi im.

Fatmir Xhafaj – Cili është mendimi juaj, zoti Ago?

Adriatik Ago – Është prezumuar me refuzim, drejtori i Përgjithshëm si të drejtë diskrete të tij, kur bie ndesh me kriteret e licencimit.

Fatmir Xhafaj - Kur përmbushen kërkesat e ligjit. Dakord.

Konform ligjit.

Miratohet.

Neni 16. “E drejta e ankimimit”.

Vasilika Hysi - Kam vetëm një redaktim te pika 5, të hiqet fjala “drejtpërdrejt” se është parazite. Do të themi: “Ankimimi ndaj vendimit të mosmiratimit të certifikimit të dhënë pas shqyrtimit....”

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Kush është dakord me nenin 16 me vërejtjen e bërë?

Miratohet.

Neni 17. “Ripërtëritja e afatit të certifikatës”. Jeni dakord?

Armando Subashi - Te pika 3 e hoqëm afatin. E lamë pa afat titullarin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 18. “Kontrata ndërmjet palëve”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 19. “Mbikëqyrja e veprimtarisë”. Kush është dakord?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Kam vetëm një pyetje, kur flisni për mbikëqyrje të veprimtarisë së shërbimeve, e keni fjalën për zbatimin e ligjit “Për inspektimin” që kaluam tani në parlament? Pra, për të njëjtin ligj? Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Miratohet.

Neni 20. “Kompetencat mbikëqyrëse”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 21. “Dokumenti i identifikimit”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 22. “Qendra e Kontrollit”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 23. “Uniforma e punonjësit të shërbimit”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 24.

Po, zoti Frroku.

Mark Frroku - Uniformat duhet të jenë të gjitha njëloj për të gjitha kompanitë, apo mundet t’i kenë sipas dëshirës së tyre? Uniforma e vjetër është e shpëlarë. Uniforma e vjetër nuk duhet të ekzistojë më, pasi nuk shihet më me sy. Pra, problemi është ky: të jetë një uniformë apo mund t’i kenë ato sipas dëshirës së tyre?

Fatmir Xhafaj – Është me udhëzim të ministrit.

Po, zoti

Burrë - Qëllimi i këtij ligji është të bëjë unifikimin e uniformave. Do të ketë një, mjafton që të mos jetë e barabartë me uniformat e Policisë së Shtetit me agjencitë e tjera ligjzbatuese. Do të bëhen të reja dhe do t’i nënshtrohen këtij ligji.

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord me nenin 23?

Miratohet.

Neni 24.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Kam tri redaktime. Lidhur me germën “d” ju thoni të vërë në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit sa herë që kërkohet punonjësit e shërbimit dhe mjetet e transportit në rastet e ngjarjeve kriminale. Ne nuk i përdorim fjalët “ngjarje kriminale”. Ju në polici i përdorni, por në ligj nuk përdoren. Në rastet kur është në tentativë ose në kryerje të një vepre penale, e para, te germa “h” që aty ku thuhet: “Të mos kufizojë apo cenojë liritë dhe të drejtat e njeriut, hapësirat e territorit publik”, sugjeroj të thuhet: “Të respektojë liritë dhe të drejtat e njeriut, hapësirat dhe territoret publike”.

Te germa “l”, të thuhet: “Të ushtrojë aktivitetin e shërbimit brenda qëllimeve për të cilat është licencuar”. Pra, të mos e kthejmë në fjali negative. Të themi detyrat që duhen bërë. Të mos themi: “Të mos e përdorë aktivitetin e shërbimit jashtë qëllimit për të cilin është i licencuar, por të themi: “Të përdortë aktivitetin e shërbimit brenda qëllimit për të cilin është licencuar.

Fatmir Xhafaj – Me natyrë pozitiviste janë të gjitha. Jeni dakord?

Adriatik Ago - Jemi dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 2 me sugjerimet e zonjës Hysi.

Neni 25. “Drejtuuesi teknik”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 26. “Përgjegjësitë e drejtuesit teknik”. Ka pyetje? Nuk ka. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 27. “Përgjegjësitë e punonjësit të shërbimit”. Ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Është çështje redaktimi. “Të përdorë mjetet e transportit të dhënë për shërbim vetëm për qëllimet...”

Fatmir Xhafaj – Është e njëjta gjë. Jeni dakord për germën “ë” me redaktim?

Adriatik Ago - Po, jemi dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Miratohet neni 27 me sugjerimin redaktorial.

Neni 28. “Verifikimi i besueshmërisë”.

Kush është dakord?

Vasilika Hysi – Jam dakord që duhet të bëhet verifikimi i besueshmërisë, por duhet të përcaktohet, pasi nuk mund të lihet nga strukturat e policisë, por nga strukturat përgjegjëse të policisë, jo nga çdo lloj strukture. Ju duhet të keni besoj në ministri një rregull, se cili e bën verifikimin e besueshmërisë.

Fatmir Xhafaj - Po, dakord. Zoti Ago, jeni dakord?

Adriatik Ago - Po, dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet me sugjerimin e bërë.

Neni 29. “Trajnimet për punonjësit të shërbimit”. Kush është dakord?

Armando Subashi – Realisht, ajo çfarë parashikon ky ligj në terren do të thotë njëlloj “revolucion”, sepse të gjitha shoqëritë mund të kenë punonjës shërbimi nga 20-30-40-100 dhe do të duhet që të gjithë këta duhet t’ia nënshtrojmë pikërisht këtij lloj trajnimi. Në të gjithë Shqipërinë nuk e di sesa mund të jetë sot ky numër. A është në gjendje akademia, shkolla e policisë që të përballojë një dyndje të menjëhershme, sepse, në rast të kundërt, do të pezullonte punën. Menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të duhej që të gjitha kompanitë, punonjësit e shërbimit, rojet, duhet t’i certifikonin me certifikatën përkatëse. Që të merrnin certifikatën, punonjësit e zakonshëm të shërbimit, duhet të bënin këtë trajnim në këtë shkollë. E përballon shkolla një dyndje të menjëhershme, apo mund të ketë nevojë në nenet e mëposhme për të lënë një afat? Si e mendoni? A shikohet mundësia që përveç shkollës shtetërore në një të ardhme të afërt apo më të largët të hapet edhe një qendër private trajnimi e tillë kundrejt të gjitha rregullave strikte?

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Lidhur me trajnimet për punonjësit, unë pajtohem me kolegun Subashi dhe sugjeroj të shtojmë një dispozitë tranzitore për t’u dhënë kohë kompanive

ekzistuese të licencuara që brenda një periudhe kohe që ju mund ta përcaktoni më mirë, duke pasur parasysh edhe kapacitetet e shkollës dhe duke ditur gjendjen e stafëve ato që kanë, të themi t'i trajnojnë brenda 3-6 muajve.

Kam edhe një sugjerim të dytë, që krahas trajnimit fillestar është mirë që hera herës të ketë edhe një freskim të ndonjë trajnimi vazhdues, sepse mund të ndryshojnë ligjet, jo vetëm këta, por edhe punonjësit aktualë të Policisë së Shtetit kanë nevojë të kenë trajnime, që të mësojnë ligjet e reja që kalojmë ne. Po kalojmë një paketë të madhe të ligjeve, nëse nuk ka trajnime vazhduese...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka vetëm afatet e trajnimit, por nuk përmendet trajnimi vazhdues. Është trajnimi fillestar dhe trajnimi vazhdues.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk është shkolla e Magjistraturës.

Po, zoti Frroku.

Mark Frroku - Mendoj se trajnimet të bëhen edhe nga një subjekt privat, sepse është e pamundur të bëhen nga kjo shkollë. Jam dakord me deputetin Subashi. Do të krijohet një bllokim.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Për nenin 29 kam një pyetje për ekspertët. Përse duhet të jetë më i besueshëm institucioni arsimor policor përkatës dhe nuk mund ta ketë të drejtën një institucion arsimor policor privat, kur mund të punojë shumë mirë me trajnerë të licencuar nga Ministria e Brendshme? Një subjekt që i ke dhënë të drejtën të ketë polici private dhe të ketë një drejtues me gradë të lartë policore, nuk ka të drejtën të trajnojë personelin e shërbimit?

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Fino.

Bashkim Fino- Faleminderit, zoti kryetar!

I dëgjova kolegët dhe kam përshtypjen se e kanë gabim, për arsyen e vetme se këtu bëhet fjalë për trajnimin e policisë private. Në fakt policia jep licencën dhe është më e specializuara, pasi është Policia e Shtetit. Kemi bërë disa ligje dhe po bëjmë për policinë në përgjithësi, për eksperiencën që kanë, për marrëdhëniet që kanë edhe me policinë e vendeve të tjera. Nuk mendoj se nuk i kanë kapacitetet që Policia e Shtetit të bëjë trajnimet edhe për policinë private. Mendoj të mbetet siç është, sepse në vend që ta lehtësojmë policinë, duke hequr këtë lloj trajnimi, mund ta rëndojmë nesër në detyrat e përditshme që do të ketë dhe duhet t'i bëjë saktë policia private.

Projektligji nga qeveria për këtë çështje ka ardhur i saktë dhe pretendoj që kolegët e mi të mirëkuptojnë se do të jetë shumë mirë që Policia e Shtetit dhe kjo shkollë që kanë

të bëjë të gjitha trajnimet e të gjithë njerëzve që jo vetëm marrin licencën, por edhe punojnë me policinë private.

Burrë - Edhe unë do të përkrah zotin Fino, Mendoj se është një nga ligjet më të mira edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative që ka sjellë Ministria e Brendshme.

Fatmir Xhafaj - Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Ne sapo kaluam ligjin “Për armët” dhe në nenin 18 i kemi dhënë të drejtën organit përgjegjës, Policisë së Shtetit, të japë licenca për aftësim teorik dhe praktik për armët. Pra, nuk ka përse ta bëjë vetëm Akademia e Rendit. Të gjithë ata që janë të licencuar për këtë lloj aftësimi, mund t’i trajnojnë këta lloj njerëzish.

Fatmir Xhafaj - Edhe një herë. Unë mendoj të ecim në këtë fazë dhe të vendosim një dispozitë tranzitore që ta shtrojmë në kohë apo jo zoti Ago?

Siç thotë zoti Subashi, nëse janë një mijë veta, të mos pengohen në kohë deri në trajnim, pra të mos ketë kushte që ta pengojë, por në këtë fazë, kur t’i vijë radha, të trajnohet. Unë them ta shqyrtojmë në një kohë të dytë mundësinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jeni dakord me sugjerimet?

Miratohet.

Neni 30. “Papajtueshmëria me funksionin”.

Ermonela Felaj – Mendoj se këtu është vendi të përcaktojmë konfliktin e interesit, që e thamë.

Fatmir Xhafaj - Zoti Ago, jeni dakord?

Adriatik Ago - Po, dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 29 kaloi siç është, por do të vendosim një dispozitë tranzitore që të rregullojmë kohën.

Neni 30 u miratua me shtesën që do të bëhet për konfliktin e interesave.

Neni 31. “Administrimi i të dhënave”.

Vasilika Hysi - Kam diçka redaktoriale. Te pika 2 themi: “Subjektet e licencuara duhet të sigurojnë që mbajtja dhe përpunimi i të dhënave është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Fatmir Xhafaj – Po, shtohet fjala “mbajtja”.

Vasilika Hysi - E treta, për të hequr dy herë përdorimin e fjalës “të dhëna”, sugjeroj: “Subjektet e shërbimit janë të detyruara të japin çdo informacion të administruar në bazën e të dhënave të tyre”.

Fatmir Xhafaj - Jeni dakord me nenin 31?

Miratohet.

Neni 32. Kush është dakord?

Ermonela Felaj - Nuk jam dakord me këtë nen, të paktën me titullin. Mbikëqyrja elektronike të çon te ligji “Për mbikëqyrjen elektronike” dhe është një gjë komplet tjetër.

E dyta, unë them se përdorimi i pajisjeve elektronike sot në vitin 2014 duhet të jetë i detyrueshëm. Të mos ketë një kamera, një kompjuter shoqëria e ruajtjes fizike? Nëse ndodh një ngjarje kriminale, ne i kemi hequr mundësinë vetes për administrimin e provave, sepse ai nuk ka këto mjete që duhet t’i ketë.

Fatmir Xhafaj - Zoti Ago, jeni dakord?

Adriatik Ago - Jam dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 33. “Përdorimi i forcës”.

Vasilika Hysi - Lidhur me përdorimin e forcës mendoj se duhet të sqarojmë më mirë në pikën 2, foljen që përdoret: “përzgjedh”. Punonjësi i shërbimit të forcës nuk përzgjedh, por përdor forcën në mënyrë të përshkallëzuar. Fjala “përzgjedh” tregon se ka shumë mundësi dhe zgjedh kë të dojë, pra duhet të jetë më e rregullt. Pjesa e fundit e fjalisë ku thuhet se mund të përdorë bindje me fjalë, shkopin e gomës, deri te përdorimi i armëve të zjarrit, mendoj që pas fjalëve “shkopit të gomës” të vendosim pikë dhe të themi: “Përdorimi i armëve të zjarrit duhet të jetë në kushtet e domosdoshme dhe sipas ligjit “Për përdorimin e armëve të zjarrit”.

Te pika 4 thuhet: “Të dëmtuarit nga përdorimi i forcës i jepet ndihma e parë mjekësore në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur”. Fjala “e mundur”, duhet të hiqet. Është e nevojshme dhe është detyrë e punonjësit të policisë të gjejë mjetet dhe mundësitë për ta çuar personin në qendrën mjekësore sa më shpejt që të jetë e mundur.

Fatmir Xhafaj - Zoti Ago, jeni dakord me sugjerimet që bëri zonja Hysi?

Adriatik Ago - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet.

Neni 34. Kush është dakord?

Bashkim Fino - Nuk dua të zgjatem shumë, pasi e vlerësoj zonjën Hysi, ka njohje më të madhe në fushën e të drejtave të njeriut, por ka një problem shumë të thjeshtë. Ai mund të jetë në majë të malit dhe nuk ka mundësi, nuk është e mundur ta ndihmojë dhe nesër ai mund të dënohet penalisht, sepse i thotë: përse nuk e ndihmove të dëmtuarin, sepse e ke në ligj? Pra, duhet të shihet në një aspekt shumë të gjerë, në shumë raste. Jo se fjala “e mundur” i thotë edhe e ndihmon, edhe nuk e ndihmon, jo, ajo i thotë se në çdo rast duhet t’i jepet ndihma mjekësore, vetëm kur është e nevojshme dhe e mundur. Po kur e ka të pamundur? Ti thua , përse nuk ia dhe ndihmën mjekësore dhe meqenëse e ke në ligj, unë të procedoj? Çfarë domethënë kjo? Duhet ta kuptojmë më gjerësisht, sepse i bie

që ne i bëjmë ligjet, ato kalojnë shpejt e shpejt por mund të rëndojnë tek ata që punojnë atje.

Fatmir Xhafaj – Mund të thuhet: “ Për sa është e nevojshme dhe e mundshme”.

Miratohet me sugjerimin.

Neni 34. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 35. Kush është dakord?

Vasilika Hysi – Punonjësi i shërbimit vetëm gjatë kryerjes së detyrës e përdor armën e zjarrit në kushtet e mbrojtjes dhe nevojës ekstreme sipas rregullave të përcaktuara.

Zoti kryetar, e them këtë, sepse vitin e kaluar kemi pasur shumë raste, kur janë hequr familjet nga banesat e ish-pronarëve, kam qenë dëshmitare vetë në disa raste, kur policitë private kanë përdorur shkopinj të gomës, dhunën dhe armën e zjarrit në ajër dhe Policia e Shtetit bënte sehir.

Fatmir Xhafaj – Neni 36. Kush është dakord?

Miratohet.

(Zoti Fatmir Xhafaj flet pa mikrofon.)

Neni 37. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 38. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 39. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 40. Kush është dakord?

Ermonela Felaj - Te neni 40, germa “c” themi: “Subjektit të SHPSF-së i hiqet licenca kur është marrë vendimi i formës së prerë nga gjykata, si masë penale plotësuese”. Unë them nëse titullarin ka një vendim të formës së prerë dënimi, duhet t’i hiqet licenca atij subjekti, sepse titullari është ai që përfaqëson marrëdhëniet me të tretët e kështu me radhë dhe nuk kemi përse të përdorim dënimin plotësues. Ti nuk e licencon nëse titullari është i dënuar, dhe me të njëjtin arsyetim i bie, që nëse dënohet, do t’i heqësh licencën.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, me mikrofon!

Adriatik Ago - Zonja deputete, në raport me ligjin aktual ne e kemi vendosur si kriter kufizues për një njeri që është i certifikuar. Do të presim 4 vjet për ta kontrolluar? Me të marrë vesh, i bie të ekzekutosh vendimin e gjykatës për dënim plotësues në një rast të veprës penale.

E kemi vendosur, sepse nuk e kemi pasur. Praktika na ka detyruar që ta vendosim. I kishin marrë masat plotësuese nga gjykata dhe ne nuk kishim dijeni.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Më falni nëse gabo, se u bë kohë që jemi duke diskutuar. Nëse një titullar i një shoqërie të ruajtjes publike dënohet, shoqërisë i duhet t'i hiqet licenca dhe ne nuk duhet të presim që gjykata të marrë ose jo ndaj këtij subjekti një dënim plotësues. Dënimet plotësuese janë me afat. Dënohet titullari, të hiqet licenca. Kaq. Përse duhet të vihet dënim plotësues? Dënimi plotësues nuk jepet pa dënim kryesor.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ago.

Adriatik Ago - Zoti kryetar, kur titullari dënohet kjo gjë nuk diskutohet. Kemi lënë vetëm vendimin e formës së prerë. Mund të jetë dënuar me gjobë, por ka masën plotësuese dhe në këtë rast ne kemi interes t'ia heqim.

Fatmir Xhafaj - Këtu kemi rastin për subjektin, kurse më poshtë te neni 41, kemi për titullarin.

Kush është dakord me nenin 40?

Miratohet.

(Zoti Bashkim Fino flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Është te germa “e” kur punëson persona të pacertifikuar sipas kërkesave të këtij ligji dhe u referohet neneve 10 dhe 11. Atje e kemi vënë kushtin.

Neni 41.

Bashkim Fino - Kam një vërejtje. A mos është e tepërt kjo fjalia e fundit: “Me vendim të arsyetuar të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë? Pse e them këtë? Kur thuhet: “heqja e licencës së titullarit të subjektit dhe të drejtorit teknik”, i merr me radhë, kur humbet kushtet dhe kriteret me kërkesën e titullarit të subjektit, kur është marrë vendimi i formës së prerë, kur ka marrë masë disiplinore, kur konstaton shkelje, më mirë të vëmë pikat sesi duhet të hiqet, sesa...

Fatmir Xhafaj - Pikat janë këto dhe thuhet: “Kjo bëhet me vendim”.

Bashkim Fino - Nuk thuhet ashtu. Kjo është një nga pikat.

Më falni!

Fatmir Xhafaj – Duhet të ketë vendim është ideja. Ka të drejtë zoti Fino.

Bashkim Fino - Mund të mos jenë gerrat “a”, “b”, “c”, “d” dhe unë jam drejtori i Përgjithshëm, me një vendim të arsyetuar mund t'ia heq licencën. Me çfarë vendimi të arsyetuar? Mbi bazën e germave “a”, “b”, “c” “d” ? Apo ka ndonjë pikë tjetër që ta shtojmë?

Fatmir Xhafaj - Masa merret me vendim të arsyetuar?

Po, zoti Ago.

(Zoti Ago flet pa mikrofon.)

E keni futur ju, edhe te neni 41 edhe te neni 42.

Jeni dakord me nenin 41?

Miratohet.

Neni 42. Kush është dakord me vërejtjen që bëri zoti Fino?

Miratohet.

Neni 43. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 44. “Gjobat për subjektin e licencuar”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 45. “Gjobat për drejtuesin teknik”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 46. “Gjobat për punonjësën e shërbimit”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 47. “Kompetenca e dhënies së masave”. Kush është dakord? Miratohet.

Neni 48. “Tarifat financiare”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 49. “Dispozitat kalimtare”. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 50. “Aktet nënligjore”. Kush është dakord me sugjerimet që u bënë gjatë shqyrtimit të projektit?

Miratohet.

Ermonela Felaj - Pse ministrit të Financave vetëm për të nxjerrë udhëzimin mbi tarifat i japim 6 muaj kohë, ndërkohë që ministrit të Brendshëm për të nxjerrë disa i japim tre muaj kohë?

Fatmir Xhafaj - Po e dinë që është punë parash dhe do t’i mbledhë ai, por nuk është ashtu.

Kam një pyetje, kërkoj ndjesë se e kalova, bëj edhe unë gabime. Te dispozitat kalimtare, keni vënë gjithë këto kushte, ai që e ka, a nuk do t’i nënshtrohet këtij ligji? Ka një dispozitë kalimtare këtu.

Vasilika Hysi - Keni shumë të drejtë.

Fatmir Xhafaj - Keni vënë gjithë këto rregulla të reja, gjithë këto gjëra dhe nuk keni vënë dispozitën kalimtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do t'i nënshtrohet një kontrolli të ligjit. Duhet të lësh një afat. I nënshtrohen verifikimit për 6 muaj, janë të detyruar. Duhet të vendosim një dispozitë tranzitore që brenda 3 ose 6 muajve pasi të kenë dalë edhe aktet, ata janë të detyruar të plotësojnë këtë gj; nëse jo, u hiqet licenca. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta përmirësojmë.

Zoti Ago, jeni dakord?

Adriatik Ago - Jemi dakord me sugjerimin.

Fatmir Xhafaj - Të vendosni te dispozita kalimtare që t'i nënshtrohen 6 muaj.

Dakord.

Neni 50. "Aktet nënligjore". Keni ndonjë gjë? Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 51. "Dispozita përfundimtare". Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 52. "Hyrja në fuqi".

Po, zoti Subashi para se ta votojmë në tërësi.

Armando Subashi – Kam dy shqetësime nisur nga ajo çfarë ndodh në praktikë. Ju kërkoj ndjesë, këto kompanitë a kanë ndonjë kufizim lidhur me rekrutimin e numrit të punonjësve të shërbimit? Kjo është pyetja e parë.

Adriatik Ago - Aktualisht jo. Me këtë ligj nuk kanë kufizime, ndërsa me ligjin e vjetër kanë pasur. Ka qenë 0,5% në raport me numrin, ndërsa ky ligj nuk i vendos kufizim. Është e drejta e tij, sa të ketë fuqi me iniciativën e lirë dhe me punësimin. Nuk ka kufizim as për burimet njerëzore, as për pajisjet dhe as për armët.

Armando Subashi – Pyetja e dytë, a mendoni se mund të shtojmë ndonjë dispozitë këtu për të mbrojtur nivelin fundor, sidomos punonjësit e shërbimit në lidhje me pagën, në referencë të pagave që ka Policia e Shtetit? Shumë mirë bëmë që e forcua ligjin, tani edhe një roje të thjeshtë do ta marrim, do ta trajnojmë, do t'i japim certifikatë e kështu me radhë dhe si përfundim ajo që ndodh në terren, është se ai katandiset me 150 mijë lekë të vjetër rrogë. Nëse rritëm gjithë këto kritere, a mendoni se mund të bëjmë diçka të tillë në këtë ligj në referencë të pagës që ka Policia e Shtetit? Nuk po them ta barazojmë, por edhe po ta barazonim nuk do të ishte keq, por një gjë duhet ta vendosim. Rriten kriteret, po kërkojmë të rriten cilësisht, por me 150 mijë lekë rrogë nuk të vjen njeri atje. Të jemi realistë. Ne e shikojmë përditë se çfarë ndodh në praktikë.

Adriatik Ago - Na ndihmon dot me një koncept neni ?

Armando Subashi - Unë të ndihmoj po të më sjellësh një tabelë të pagave sesi paguhen në Policinë e Shtetit....

Adriatik Ago - Ne nuk i kemi hyrë këtij problemi, sepse është veprimtari që rregullohet me akte të tjera.

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord në parim?

Miratohet.

Mbyllet rendi i ditës për sot me të gjitha projektligjet që kishim në shqyrtim. Rezoluta për KQZ-në do të shtyhet për nesër, në mënyrë që të diskutojnë përsëri nënkryetari i komisionit me relatorin.

Mbledhja tjetër është nesër në orën 9.00 sipas rendit të ditës së kalendarit. Pasdite nuk do të ketë për shkak se do të bëjmë një organizim tjetër me Komisionin e Sigurisë për ta bërë bashkë shqyrtimin në parim të projektligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Shumë faleminderit zotërinjve të Ministrisë së Brendshme, jo thjesht për prezencën, për kontributin, por edhe për punën konkrete! Falënderoj kolegët!

Faleminderit Adit dhe kolegëve të tij të medias!

Punë të mbarë të gjithëve!

Mbyllet mbledhja.